



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“E Drejtë Penale”
Koleji Universitar “Wisdom”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Ëngjëll LIKMETA

Prof. Asoc. Dr. Skerdian KURTI

Maj / 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Wisdom”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i së Drejtës Publike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Msc në “E Drejtë Penale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 241, datë 31.05.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 468, date 02.10.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr.236, datë 09.05.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 33 studentë; 2021-2022 14 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Wisdom", ish Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Wisdom University" është krijuar nga shoqëria "Wisdom" sh.p.k. mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.672, datë 27.09.2006. Me Urdhër Nr.412 datë 25.08.2011 të MASR është miratuar riorganizimi i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Wisdom University" me dy fakultete, Fakulteti i Drejtësisë me tre njësi bazë, Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Private, Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Mardhënieve me Jashtë, dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike e Shoqërore me tre njësi bazë Departamenti i Ekonomisë, Departamenti i Psikologjisë, Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Mardhënieve me Jashtë. Mbështetur në nenin 20, 33 dhe 129 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik me Vendimin Nr. 6, datë 03.02.2017 vendosi riorganizimin e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Wisdom University" në Kolegj Universitar, me emërtimin Kolegji Universitar "Wisdom". Me Vendim të Bordit të Akreditimit VBA Nr.51, datë 27.11.2020 është bërë Akreditimi Institucional me kohëzgjatjen prej 4 (katër) vite akademike.

Hapja e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", me kohë të plotë, me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike është bërë me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.241, datë 31.05.2011 "Për hapjen e programeve të reja dhe fillimin e veprimtarisë akademike për këto programe pranë Shkollës së Lartë Universitare, jo publike, "Wisdom University", Tiranë". Njësia bazë që ofron programin e studimit është Departamenti i së Drejtës Publike, pranë Fakultetit të Drejtësisë. Për herë të parë, akreditimi i programit të studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" është bërë me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr.356 datë 25.09.2015 "Për akreditimin me kusht të programeve të studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave" në "E Drejtë Civile dhe Tregtare" dhe "E Drejtë Penale", të ofruara nga Shkolla e Lartë Universitare, Jopublike "Wisdom University", bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr.48 datë 29.06.2015. Me anë të Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr.236 datë 09.05.2016 "Për plotësimin e kushteve për akreditim të programeve të vendosura me urdhërin Nr.356 datë 25.09.2015 "Për akreditimin me kusht të programeve të studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave" në "E Drejtë Civile dhe Tregtare" dhe "E Drejtë Penale", të ofruara nga Shkolla e Lartë Universitare, Jopublike "Wisdom University", është vendosur plotësimi i kushteve për akreditim dhe vijimi i akreditimit për Masterin Shkencor në "E Drejtë Penale" sipas të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga kuadri ligjor në fuqi për arsimin e lartë, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr.140, datë 18.02.2016. Ky program studimi është organizuar në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe 120 ECTS, ku çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra. Në përputhje me Statutin e IAL, të Rregullores së posaçme për këtë program studimi, nisur nga informacioni i marrë gjatë vizitave në institucion por edhe nga RVB, misioni i programit të studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" është ndihma që i jepet shtetit me anë të përgatitjes së specialistëve në fushën penale. Përsa i përket objektivave mund të përmendim këtu: përgatitjen e studentëve me njohuri të avancuara në fushën


e të drejtës penale, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; krijimin e kompetencave profesionale për të zhvilluar karrierën personale në fushën e së drejtës penale; pajisjen me aftësi për punë të pavarur shkencore dhe studime të mëtejshme në fushën penale; përgatitjen e studentëve me njohuri bazë të komunikimit dhe me një etikë profesionale në fushën penale; përgatitja e studentëve me qëllim që t'i shërbejnë më së miri nevojave të administratës shtetërore në përmbushjen e detyrave në fushën penale.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi i studimit Master i Shkencave në E Drejtë Penale, është akredituar me Urdhër të MAS Nr. 236, datë 09.05.2016, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 140, datë 18.02.2016. Referuar këtij vendimi Këshilli i Akreditimit **nuk ka lënë rekomandime** për këtë program studimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit të ciklit të dytë master i shkencave në “E Drejtë Penale” është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kolegji Universitar “WISDOM” ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Msc në “E Drejtë Penale”, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga KU “Wisdom”, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. As.Dr. Skerdian Kurti dhe Prof. As.Dr. Ëngjëll Likmeta. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Vizita në KU “Wisdom”, u realizua në datat 1 dhe 2 Mars, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësin e Departamentit dhe Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore etj. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mblodhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.




Kolegji Universitar “WISDOM”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 13.05.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 55/11 Prot, datë 13.05.2022. Kolegji Universitar “WISDOM”, përcjell në ASCAL më datë 18.05.2022, me anë të shkresës me Nr. 103 Prot, datë 16.05.2022, “Për Draft Raportet e Vlerësimit të Jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË “E DREJTË PENALE”

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Kolegji Universitar “Wisdom” (KU“Wisdom”) zotëron të gjithë mekanizmat e nevojshëm në raport me funksionimin dhe organizimin e programit të studimit në përputhje me të gjitha aktet rregullatore të tij, si statuti, rregullore e kolegjit, rregullore e programit të studimit etj. Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira në Shqipëri dhe në vendet Evropiane. Ky program studimi është ndërtuar në përputhje me objektivat që ndjek IAL dhe që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Masteri i Shkencave në “E drejtë penale” synon të ofrojë njohuri për studentët me qëllim që ata të ndërtojnë një karrierë profesionale dhe akademike cilësore, në përputhje me interesat kombëtare, në fushën e së drejtës dhe në mënyrë të veçantë të së drejtës penale.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statuti i KU “Wisdom”,</i></p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore KUW</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”,</i></p>

Thurter




	<i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” e zhvillon veprimtarinë mësimore shkencore duke respektuar lirinë dhe cilësinë akademike. Plani mësimor për këtë program studimi përfshin lëndë dhe module që synojnë konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Personeli akademik i këtij program studimi ka për detyrë të kërkojë nga studentët një frymë etiko-morale të tillë që të jetë në përputhje me vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. Ky program studimi është i përshtatur dhe reflekton vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. Në këtë program gjejmë trajtime të temave që kanë në përmbajtje të tyre interpretimin e normave ligjore me karakter kombëtar.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statutin e KU “Wisdom”,</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”,</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimor</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>KU “Wisdom” ka për qëllim t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke integruar rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm që ti shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si edhe partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare. Misioni i këtij institucioni të arsimit të lartë është zhvillimi i arsimit dhe shkencës në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për zhvillimin e ekonomisë, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente. Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” synon të nxjerrë studentë të aftë dhe të mirë përgatitur në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statutin e KU “Wisdom” Neni 3-4;</i></p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom” Neni 8 dhe 42;</i></p> <p><i>Aneks 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit i Kolegjit Universitar “Wisdom” 2018-2023;</i></p>

Thurta



	<p><i>Aneks 3.01 Rregullore "Për Programin e Studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, në "E Drejtë Penale", neni 7;</i></p> <p><i>Aneks 2. 08 Rregullore Departamentit të së Drejtës Publike;</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Bazuar në vizitat e zhvilluara në institucion, GVJ u informua se ka një numër të konsiderueshëm studentësh që pasi kanë mbaruar programin e studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" kanë gjetur punë ose kanë bërë këtë program studimi pasi u duhej për të zhvilluar aftësitë që i kërkonte vendi i punës. Për pasojë, GVJ konstaton se programi studimor Master i Shkencave në "E drejtë penale" është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Kjo gjë vihet re në mënyrë specifike edhe nga analiza e programeve të lëndëve që janë pjesë e këtij programi studimi, ku gërshetohen thellimi i njohurive në fushën penale kombëtare me njohuritë në fushën penale ndërkombëtare të domosdoshme për nevojat e sotme të tregut të punës. Programi i studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. Një pjesë e mirë e lëndëve të këtij program studimi e mbajnë parasysh këtë fakt dhe përpiqen ti trajtojnë çështjet edhe në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2. 10 Studimi i Tregut, fq 13-21.</i></p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom", Neni 8 dhe 42.</i></p> <p><i>Aneks 1.09 Rregullore e ZBNjKK & JS, Neni 6 pikat 13-25.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" Neni 2.</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimor</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Të diplomuarit e këtij program studimi mund të vazhdojnë studimet në ciklin e tretë dhe do të kenë më shumë përparësi në kërkimet shkencore në fushën penale. Një ndër synimet kryesore të këtij program studimi është jo vetëm të mundësojë një kualifikim shkencor të profesionistëve të rinj me njohuritë e thelluara por edhe të krijojë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" Neni 7.</i></p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike.</i></p>

Thurbi



	<i>Aneks 3.03 Plani Mësimor</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit MSH është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është në përputhje edhe me strategjinë për zhvillim të institucionit. Bazuar në Planin strategjik të zhvillimit të institucionit për vitin 2018-2023 janë hartuar edhe programet e studimeve. Përgatitja e programeve të studimit është në përputhje, ndër të tjera me strategjinë e zgjerimit të këtij institucioni të arsimit të lartë, gjithmonë duke mbajtur të pacënuar cilësinë. Programi i studimit reflekton kulturën institucionale, vlerat, misionin dhe vizionin e institucionit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statutin e KU “Wisdom”, neni 3.</i></p> <p><i>Aneks 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit i KU “Wisdom” 2018-2023.</i></p> <p><i>Aneks 1.14 Strategjie Kërkimit Shkencor, projekteve, Partneriteteve e mobilitetit ndërkombëtar.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” Neni 3.</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, përputhet me kriteret e përcaktuara ligjore dhe nënligjore. Përmbajtja e këtij programi studimi është ndërtuar duke respektuar dhe zbatuar kërkesat e Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren, në KU “Wisdom”, nxënia mbetet funksioni qendror dhe mësimdhënia ndaj studentëve është qëllimi kryesor i institucionit. Ky qëllim arrihet duke vlerësuar dhe mbështetur risitë në metodat e mësimdhënies dhe duke promovuar kontributet e secilit pedagog</p>

Thurta

	<p>në lidhje me to në shkallë universiteti, por edhe në nivel kombëtar.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statutin e KU "Wisdom" Neni 3 dhe 4.</i></p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom", Neni 8 dhe 42/1 "Niveli i studimeve".</i></p> <p><i>Aneks 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit i Kolegjit Universitar "Wisdom" 2018-2023.</i></p> <p><i>Aneks 2.22.3 Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në FD.</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>KU "Wisdom" ofron studime universitare të ciklit të parë, të ciklit të dytë, studime të integruara në drejtësi dhe veprimtari mësimore e trajnuese profesionale në përputhje me legjislacionin në fuqi. Emërtimi, organizimi dhe struktura e programit të studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" është në përputhje të plotë me drejtimet akademike të institucionit. Ky program studimi është organizuar në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe 120 ECTS, ku çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statuti i KU "Wisdom", neni 13.</i></p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom", Neni 42.</i></p> <p><i>Aneks 2. 08 Rregullore e Departamentit të së Drejtës Publike, neni 4-5.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" Neni 5.</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimor</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>GVJ konstatoi se KU "Wisdom" mundohet të krijojë një mjedis që promovon të mësuarin e angazhuar, aktiv dhe interaktiv, që ka si qëllim të tij final të përgatisë studentët në profesionet e tyre të ardhshme të punës, si dhe që do të dinë që t'i trajtojnë problemet sipas qasjeve kritike dhe analizuese, gjithmonë duke i shërbyer edhe dialogut konstruktiv në nivel institucioni, kombëtar, rajonal dhe global. Programi i studimit master i shkencave në "E drejtë penale" është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p>

Thurati

	<p><i>Aneksi 2. 10 Studimi i Tregut, fq 11-21.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", Neni 7 pika 4</i></p> <p><i>Aneks 2. 11 Plani Strategjik 2018-2023</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3


Programi i studimit "Master i shkencave" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit Master i shkencave në "E Drejtë Penale" ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këtë program. Qëllimi i këtij program studimi, ndër të tjera, është të ofrojë njohuri teorike dhe aplikative duke paraqitur para studentëve programet e duhura për një përgatitje sa më të plotë akademike dhe profesionale në fushën e drejtësisë. Ky program studimi është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare që synon integrimin në tregun ekonomik evropian.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneksi 2. 10 Studimi i Tregut, fq 11.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", Neni 7.</i></p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimor</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e</p>	<p>KU "Wisdom" bën përpjekje për të kryer studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale". Studimet mbi tregun e punës janë bërë jo vetëm përpara hapjes së këtij program studimi por vazhdojnë të bëhen në mënyrë periodike nga ana e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore. Bazuar në vizitat e zhvilluara në Institucion, GVJ u informua se ka një numër të konsiderueshëm studentësh që pasi kanë mbaruar këtë program studimi në KU "Wisdom"</p>

Mhertiu

<p>punësimin të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>kanë gjetur një punë ose e kanë bërë këtë program studimi pasi u duhej për të zhvilluar aftësitë që i kërkonte vendi i punës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.09 Rregullore e ZBNjKK & JS</i></p> <p><i>Aneks 2. 10 Studimi i Tregut, fq 22.</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione.</i></p> <p><i>Aneks 2.26.1 Informacion mbi Studentët e Diplomuar në KU "Wisdom" në VA 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021.</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Msc. në "E Drejtë Penale" udhëhiqet nga parimi i zhvillimit të kompetencave profesionale dhe kjo shpalolet edhe në mënyrën sesi është hartuar programi. Gjithashtu referuar mënyrës sesi do të realizojë formimin e studentit në drejtim të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale ka një sër strukturash ku mund të mbështetet siç janë struktura mësimore, plani mësimor i cili duhet parë si themelet e formësimit të studentit dhe për këtë është e rëndësishme një thellim në dije, njohuri e aftësi specifike në fushën penale. Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" mundëson specializimin e mëtejshëm të studentëve me aftësi dhe kompetenca që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e tyre.</p> <p>Aktualisht kurrikulat e lëndëve janë në gjendje për të realizuar përgatitje të mirë të studentëve, por <i>GVJ sugjeron se përmbajtja ka nevojë edhe të përmirësohet me tema apo edhe me lëndë të tjera.</i></p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneksi 2.10 Studimi i Tregut, fq 11.</i></p> <p><i>Aneks 2.16 Relacion ndryshimi, Plani Mësimorë 2018-2019.</i></p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimor,</i></p> <p><i>Programet mësimore,</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përfaqësohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", për nga struktura dhe nga përmbajtja është i përfaqësuar me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare. Fakti që ky institucion i arsimit të lartë ka</p>

Thurta



<p>qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>studentë të cilët kanë qenë pjesë e programit Erasmus e vërteton këtë gjë. Gjithashtu organizimi i lëndëve në kredite (ECTS), e bën të mundur transferimin e studimeve dhe për rrjedhojë edhe punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”.</i></p> <p><i>Aneks 3.11 Suplementi i diplomës</i></p> <p><i>Aneks 3.08 Programet mësimore (syllabuset).</i></p> <p><i>Aneks 2.30.4 Informacion mbi grantet e përfituara në kuadër të pjesëmarrjes në programe Erasmus+ për vitet 2014-2020</i></p> <p><i>Aneks 2.26.6 Relacion për pjesëmarrjen e studentëve në Erasmus +</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimorë.</i></p> <p><i>Aneks 2. 10 Studimi i Tregut</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikrat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe direktivat e Kartës së Bolonjës për arsimin e lartë dhe mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikrat e mira të vendeve evropiane. Gjithashtu një sër elementësh të strukturës së këtij program studimi si kreditet sipas Sistemit Evropian të Trasferimit të Krediteve (ECTS), kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlersimit, profili i programit, diploma dhe suplementi i saj etj, janë të gjithë element të pranishëm që janë në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike.</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimorë.</i></p> <p><i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva</p>	<p>Programi i studimit Msc. në “E Drejtë Penale” ofrohet me kohë të plotë, i shtrirë në dy vite akademike me kohëzgjatje normale dhe organizohet me 120 ECTS. Bazuar në planin mësimor të këtij programi, studentëve u mundësohet përvoja e praktikës profesionale e cila mund të kryhet në disa qendra dhe institucione publike dhe private në vend në përputhje me realizimin e objektivave të këtij program studimi. Praktika</p>

Murtu

<p>ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>profesionale e zhvilluar nga studentët e këtij program studimi ndihmon në aftësimin profesional në përputhje edhe me direktivat ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, neni 23.</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Aneks 3.08.14 Praktikë mësimore</i></p> <p><i>Aneksi 3.10 Vendim nr. 96 Prot, dt. 07.12.2021, “Për kryerjen e praktikave mësimore ne Fakultetin e Drejtësisë, Për vitin akademik 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneks 2.36 Udhëzuesin e Praktikave.</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimorë.</i></p> <p><i>Aneks 3.08.14 Praktikë mësimore,</i></p> <p><i>Aneksi 3.10.1 Shembull i Praktikës mësimore.</i></p> <p><i>Bashkëpunimi me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për zhvillimin e praktikës mësimore,</i></p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Në programin e studimit Master i shkencave në “E Drejtë Penale”, janë përfshirë elemente të mësimdhënies në gjuhë të huaj të cilat bëjnë të mundur rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit (Përmendim këtu literaturën plotësuese në gjuhë të huaj apo marrëveshjet me institucione të huaja).</p> <p><i>Në lidhje me përmbushjen sa më të mira të kësaj pike, GJVJ rekomandon zhvillimin e moduleve apo lëndëve në gjuhë të huaj, të cilat edhe pse institucioni i ka mundësitë për ti zhvilluar kjo gjë vihet re në nivele minimale.</i></p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks1.02 Rregullore e KU “Wisdom, neni 43.</i></p> <p><i>Aneks 2. 07 Raporti vjetor i KU “Wisdom”, VA 2020-2021, fq 65.</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimorë.</i></p> <p><i>Programet mësimore,</i></p>
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe</p>	<p>Rreferuar te dhënave të marra rezulton se ky program studimi ofrohet vetëm në gjuhën shqipe dhe si rrjedhojë edhe dokumentacioni është në këtë gjuhë. Për programin e studimit</p>

Murtu

arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Master i shkencave në “E Drejtë Penale”, KU “Wisdom” përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze Dokumentacioni i shqyrtuar <i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike.-(ref. anglisht)</i> <i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit vihet re se KU “Wisdom” ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për të ofruar dhe menaxhuar një program të tillë studimi. Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i së Drejtës Publike, ka në përbërje të tij një personel akademik, shkencor dhe mbështetës të plotë për nevojat e këtij programi.</p> <p>Fakulteti i Drejtësisë për vitin akademik 2021- 2022 ka 25 pedagogë gjithsej, nga të cilët 22 janë personel akademik efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesorë i Asociuar”, 9 kanë gradën Dr., dhe 11 Asistent Lektorë me Msc, dhe 3 janë personel akademik me kontratë (PAK). Ndërsa Departamenti i së Drejtës Publike ka 7 PAE dhe 1 PAK.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 11 pedagogë gjithsej, ku 9 PAE, nga të cilët 2, Prof.Asoc, 3 me gradën Dr/PhD, si edhe 4 asistente-lektore me Msc, dhe 2 PAK nga të cilët 1 Prof.Asoc, dhe 1 me gradën Dr/PhD.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2021-2022 rezultoi 82% me 18%.</p> <p>Stafi akademik ka marrë pjesë në shkëmbime dhe kualifikime dhe ka një numër të lartë botimesh shkencore, në revista brenda</p>

Therit


	<p>dhe jashtë vendit. Persa i përket përbërjes moshore të stafit akademik, është e balancuar duke pasur grup moshë të ndryshme që mundësojnë përçimin e përvojës dhe kualifikimit brenda njësisë.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom", Neni 33-34.</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike.</i></p> <p><i>Aneks 2.22.1 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" (për të gjitha vitet).</i></p> <p><i>Aneks 2.23.1 CV e stafit akademik të programit të studimit.</i></p> <p><i>Aneks 2.28 Planimetria si dhe Kontratat qiraje</i></p> <p><i>Aneks 2.22.6 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësine kryesore.</i></p> <p><i>Aneks 2.22 Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe referimi prej takimeve gjatë vizitës në Institucion konfirmuan se fusha e Programit të studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" i ofruar nga Departamenti i së Drejtës Publike është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Drejtësisë. Programi i studimit Msc në "E Drejtë Penale" i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit i përket fushës së shkencave juridike, me drejtim specifik në E Drejtë Penale. Ajo shprehet qartë edhe në emërtimin e programit të studimit, i cili është në koherencë me atë të njësisë bazë dhe kryesore</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2. 05 Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë, neni 3.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", neni 3.</i></p> <p><i>Ref. VKM 531 dt 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të cilësisë së Arsimit të Lartë". https://www.ascal.al/sq/sigurimi-i-cilesise/kodi-i-cilesise</i></p> <p><i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike</p>	<p>Programi i studimit Msc në "E Drejtë Penale" ofrohet nga Departamenti i së Drejtës Publike, në bashkëpunim me departamente të tjera të Fakultetit të Drejtësisë. Departamenti ofron vetëm diploma në fushën juridike në tre cikle studimi</p>

Thirti

<p>e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>konkretisht: Diplomë Profesionale në “Asistent Juridik”, Bachelor në “Drejtësi”, Msc në “E Drejtë Penale” dhe Programi i Integruar Msc në “Drejtësi”. GVJ konstaton që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks 2. 05 Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë</i></p> <p><i>Aneks 2. 08 Rregullore Departamentit të së Drejtës Publike</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Institucionit vërehet të ketë një hierarki të strukturuar sipas hallkave, të cilat monitorojnë përmes mekanizmave të saj mbarëvajtjen e punës në drejtim të realizimit të detyrave nga ana e personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Njësia bazë përmes strukturave të saj kordinatori i programit të studimit grupit mësimorë, mbikqyrin monitorojnë dhe bashkëpunojnë midis tyre për qëllime të mbarëvajtjes të procesit mësimor për këtë program studimi. Një sër dokumentash e përlligjin bashkëpunimin brenda institucionit përmes ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit. Kjo vërehet duke iu referuar edhe dokumentacionit vënë në dispozicion mbi organizimin dhe funksionimin e departamentit, rregullorja mësimore e programit të studimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statuti KUV</i></p> <p><i>Aneks 2.12 Programi i veprimtarive kryesore i Departamentit të së Drejtës Publike.</i></p>

Thurta



	<p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit.</i></p> <p><i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se KU “Wisdom”, ka nënshkruar 20 marrëveshje bashkëpunimi me universitete në rajon dhe Evropë, të cilat janë shfrytëzuar për realizimin e objektivave të procesit mësimor, zhvillimin e punës kërkimore shkencore, shkëmbimin e përvojave dhe mobilitetin e studentëve. IAL ka gjithashtu 97 marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, me qëllim mbështetjen e objektivave të procesit mësimor dhe trajnimit të studentëve. Nga 117 marrëveshje gjithsej rezultoi se 80 nga këto marrëveshje janë në funksion të programit të studimit. Njësia bazë ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë e bashkëpunimit për të realizuar objektivat e përcaktuara për procesin mësimor.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione (tabelat),</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NJKSH & MJ,</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021.</i></p> <p><i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimit me pedagogët gjatë vizitës në Institucion, zbatimi i praktikave mësimore nënshkruhet dhe kryhet në institucione apo kompani private mbi bazën e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit. Marrëveshje bashkëpunimi me universitetet jashtë vendit, rezultojnë të jenë nr.20 për këtë program studimi. Zbatimi i praktikave mësimore është vlerësuar si nga studentët ashtu edhe nga pedagogët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion, si një ndër komponentët e rëndësishme të procesit mësimor, këto praktika zhvillohen në institucione/kompani sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga Departamenti i së Drejtës Publike. Gjithashtu në ndihmë të studentëve shërben dhe Qendra “Klinika Ligjore Wisdom”. Departamenti bën ndarjen e studentëve nëpër kompani/institucione pritëse, duke respektuar edhe opinionet e shfaqura prej tyre. Departamenti cakton pedagogët përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës</p>	


Thurli

<p>specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Praktikës. Studentët përpara fillimit të praktikës mësimore, pajisen dhe me Udhëzuesin e praktikave. Progresi i punës së studentit monitorohet nga institucioni pritës dhe pedagogët përgjegjës. Në fund studenti paraqet një relacion dhe prezanton detyrat e kryera/të përmbushura.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione.</i></p> <p><i>Aneks 4.08 Marrëveshje të bashkëpunimit në nivel IAL</i></p> <p><i>Aneks 4.09 Marrëveshjeve në nivel Programi Studimi</i></p> <p><i>Aneks 4.10 Marrëveshje bashkëpunimi me aktorë biznesi.</i></p> <p><i>Aneks 2.30 Shkresë mbi aktivitetin me të ftuar P.sh: Phd David Kolb; Prof. Maria Casola.</i></p> <p><i>Aneks 2.30.1 Shkresë mbi aktivitetin me të ftuar në kuadër të implementimit të marrëveshjes me CILS.</i></p> <p><i>Aneks 4.21 Marrëveshje bashkëpunimi me CILS</i></p> <p><i>Aneks 4.15 Relacion nga Qendra Klinika Ligjore "Wisdom".</i></p> <p><i>Aneksi 3.10 Vendim nr. 96 Prot, dt. 07.12.2021, "Për kryerjen e praktikave mësimore ne Fakultetin e Drejtësisë.</i></p> <p><i>Aneks 3.08.14 Programi i lëndës "Praktikë mësimore".</i></p> <p><i>Aneks 3.10.1 Shëmbull i një kërkesë/kthim përgjigje të Praktikës mësimore.</i></p> <p><i>Aneksi 3.10.2 Organizimi i një Vizite mësimore në institucionin e Policisë Shkencore.</i></p> <p><i>Aneks 2.36 Udhëzuesin e Praktikave</i></p> <p><i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar, institucioni garanton 20 bashkëpunime me institucione homologe si dhe 15 institute kërkimore shkencore, me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve. IAL është përfshirë dhe në partneritet në kuadër të Programit ERASMUS+ për shkëmbimin e stafit akademik, dhe studentëve.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.30.4 Informacion mbi grantet e përfituara në kuadër të pjesëmarrjes në programe Erasmus + për vitet 2014-2020.</i></p> <p><i>Aneks 2.20 Praktikë dokumentacion mobiliteti i stafit akademik (teaching mobility).</i></p>

	<p><i>Aneks 4.17 Shkresa për thirrje të personelit akademik për pjesëmarrje në aktivitete të kërkimit shkencor për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NJKSH&MJ</i></p>			
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Njësia bazë përmes strukturave të saj monitoron në vijimësi ecurinë e përgjithshme të programit të studimit përmes disa formave monitoruese si plani i punës i departamentit, analiza e punës së departamentit, dhe analiza e raportit të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NJKSH&MJ</i></p> <p><i>Aneks 4.04 Relacion mbi ecurinë e veprimtarive kërkimore shkencore 2017-2022</i></p> <p><i>Aneks 4.05 Relacion mbi ecurinë dhe zbatueshmërinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit 2017-2022</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga informacionet e marra gjatë diskutimeve me personelin akademik të programit mësimor në vizitën në Institucion, GVJ u bë me dije se personeli akademik nxitet dhe mbështetet të publikojë në revista shkencore, të marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në projekte dhe trajnime që lidhen me fushën e tyre të kualifikimit. Gjithashtu, konstatojmë se politikat institucionale të KU “Wisdom” mbështesin stafin në përfshirjen në një sër projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. Bazuar në relacionin për mbështetjen e stafit akademik kemi një sër nismash që synojnë të krijojnë mundësi për pjesëmarrje në konferenca apo publikime në</p>

Thurati



	<p>revista ndërkombëtare. Mbështetja e stafit lidhur me mobilitetin në mësimdhënie përmes Erasmus + etj. Këto lloj mobilitetesh kanë impact pozitiv jo vetëm tek stafi akademik por edhe në rritjen e aseteve të burimeve njërzore të vet KU' Wisdom" dhe të studentëve të saj.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom", Neni 112, Biblioteka.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.5 Vendim i Administratores së Sh.p.k "Wisdom", Për mbështetjen e veprimtarive kërkimore shkencore për VA 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneks 2.26.8 Relacion te takimit online me partnere dhe bashkëpunëtore të FD,</i></p> <p><i>Aneks 4.17.1 Relacion për personelin akademik të angazhuar në programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni në funksion të vlerësimit të ecurisë së rezultateve në fushën e kërkimit shkencor ka ngritur njësinë e kërkimit shkencor në Fakultetin e Drejtësisë, që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. Kjo njësi ka implementuar një sër projektesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në realizimin e këtyre projekteve janë përfshirë edhe pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NJKSH&MJ</i></p> <p><i>Aneks 4.01 Rregullore NjKSHMJ.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>KUW organizon veprimtari të përvitshme, të cilat shërbejnë jo vetëm për stafin akademik por edhe për studentët pjesmarrës në këto aktivitete, duke qenë se kanë mundësi të bien në kontakt me risitë e zhvillimit të fushës dhe ballafaqimin me kompleksitetin e dinamikave të zhvillimit të shoqërisë. Në kuadër të një politike promovuese të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, institucioni ka ndërmarrë një sër inisiativash që synojnë promovimin e rezultateve të kërkimit shkencor në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, leksioneve të hapura me lektorë të ftuar, dhe mbështetjen e stafit për mobilitet të pedagogëve të Njësisë së Kërkimit Shkencor.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.29.4 Propozim "Për miratimin e fondi të veprimtarive kërkimore shkencore për VA 2021-2022, të Departamentit të së Drejtës Publike".</i></p>

	<p><i>Aneks 2.29.5 Vendim i Administratores së Sh.p.k "Wisdom", Për mbështetjen e veprimtarive kërkimore shkencore për VA 2019-2020; 2020-2012; 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.6 Kriteret për alokimin e fondit vjetor të kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>Aneks 4.19 Shkresë për alokimin e fondeve për stafin që ka marrë pjesë në aktivitetet e kërkimit shkencor, projekte ndërkombëtare, mobilitete.</i></p> <p><i>Aneks 2.19.2 Plani i NjsBC veprimtarive kryesore për vitin akademik 2021-2022. nr.443 Prot, datë 05/10 2021.</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit por edhe vizitave në institucion, GVJ konstaton se institucioni merr masat e duhura për të mbrojtur pronësinë intelektuale në të gjithë botimet dhe punimet shkencore duke ndjekur parimet e rregullores së Etikës. Në ambientet e laboratorit të informatikës funksionon sistemi SPSS, si dhe një sistem për kontrollin e plagjiaturës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.18 Politika Institucionale e Publikimit të Informacionit.</i></p> <p><i>Aneks 1.17 Udhëzues për Monitorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit.</i></p> <p><i>Aneks 4.18 Model Vlerësimi mbi pronësinë intelektuale dhe antiplagjiaturë në punimet shkencore.</i></p> <p><i>Aneks 4.18.1 Politikat mbi pronësinë intelektuale dhe antiplagjiaturën.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe RVB, konstatohet se institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor duke i përfshirë në kërkimin shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar. Përfshirja e institucionit në projekte të ndryshme rrit mundësinë për stafin dhe studentët të angazhohen në aktivitete specifike përgjatë aplikimit të projektit. Në kuadër edhe të provimit final të diplomës, studentët janë angazhuar në projektet e tyre kërkimore nën monitorimin e një anëtari të stafit akademik.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NJKSH&MJ</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione</i></p> <p><i>Aneks 4.07 Botimet e Revistës Shkencore Wisdom.</i></p> <p><i>Aneks 4.07.1 Botim i studentëve të FD.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
<p>Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Msc në “E Drejtë Penale” është hartuar në harmoni me legjislacionin vendas siç janë: Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, gjithashtu duke respektuar Sistemin Evropian të Trasferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Nga shqyrtimi i planit mësimor, rezulton që Programi është i organizuar në lëndë/module, të cilat janë të vlerësuara me kredite (ECTS). Niveli i kualifikimit është sipas përcaktimeve të KSHK dhe KEK (niveli 7). Programi mësimor realizohet me 120 kredite me kohëzgjatje 2 vite akademike, i ndarë në katër semestra me peshën e fitimit 30 kredite për semestër.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, Neni 17 “Organizimi i Studimeve”.</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimorë,</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një</p>	<p>Programi i studimit Msc në “ E Drejtë Penale” përmes moduleve dhe lëndëve synon të formojë shprehi dhe kompetenca në drejtim të fushës penale. Programi përgatit studentët për kompetencat e punësimit dhe u mundëson studentëve të fitojnë dijet e</p>

Thirti

<p>Ilojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>nevojshme për t'u ballafaquar me problemet juridike, lidhur me legjislacionin në fuqi përkatësisht në fushat penale dhe publike.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Dosja e plotë Didaktike.</i></p> <p><i>Aneks 2.11 Plani Strategjik 2018-2021 Për Programin e Studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, në "E Drejtë Penale".</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së programit të studimit (<i>Aneks 3.01</i>), por edhe nga analiza që GVJ i bëri Dosjes së plotë Didaktike, konstatojmë se ky program studimi i pajis studentët me njohuri të përparuara në fushën e së drejtës penale, veçanërisht të kuptuarit kritik në disiplinat specifike penale, të cilat ofrohen në një nivel të avancuar, dhe formësojnë studentët me parimet akademike dhe teoritë bashkëkohore të fushës. Bazuar më së shumti në analizën që GVJ i bëri syllabuseve të lëndëve të programit, por edhe në diskutimet me pedagogët dhe studentët e programit të studimit, GVJ formoi bindjen se programi është strukturuar në konceptin e thellimit të njohurive aplikative duke futur mendimin kritik lidhur me zgjidhjen e problemeve shkencore dhe praktike në fusha të së drejtës penale. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezultoi se përmirësimi i kurrikulës është bërë në vitin akademik 2018-2019, gjithmonë në respekt të masës 20% të parashikuar.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Dosja e plotë Didaktike.</i></p> <p><i>Aneks 2.11 Plani Strategjik 2018-2023 "Për Programin e Studimit"</i></p> <p><i>Aneks 2.16 Relacion ndryshimi, Plani Mësimorë,</i></p> <p><i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Sikurse përmendet edhe në vlerësimin lidhur me Kriterin 1 të këtij standardi, programi i studimit është ndërtuar në përputhje me kërkesat ligjore të një programi studimi të ciklit të dytë, konform VKM nr.41 datë 24.01.2018, (i ndryshuar). Syllabuset e secilës lëndë janë të organzuara sipas strukturës së më poshtë me: përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit; objektivat dhe konceptet themelore; temat e lëndës dhe secila prej tyre përmbajnë një sër veprimtarishë praktike që realizohen si pjesë e seminareve duke lehtësuar në këtë mënyrë përvetësimin e koncepteve teorike nga ana e studentit. Syllabusi i praktikës është organizuar në mënyrë që t'u jap mundësi studentëve të</p>

Thur


	<p>përfitojnë kompetenca dhe njohuri praktike që zhvillohen pranë enteve, studiove profesionale apo institucioneve shtetërore që i përkasin sistemit të drejtësisë (gjykatë prokurori), me qëllim plotësimin e karrierës universitare. Programi përmban të gjithë elementët teorikë, praktikë dhe të vlerësimit, të punës në auditor apo të pavarur.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Dosja e plotë Didaktike.</i></p> <p><i>Aneks 2. 02 Të dhëna për aktet themelore, licencime, akreditime, të Programi i studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale",</i></p> <p><i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Veprimtaritë formuese janë konform ligjit për arsimin e lartë dhe urdhrave duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe ndarje në kredite. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A e lëndëve Bazë 8% (10 ECTS); - Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 53%(64 ECTS); - Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore / Integruese 10% (12 ECTS); - Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (12 ECTS); - Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 15 % (18 ECTS); <p>Përqindja totale e lëndëve të kategorisë A dhe B është 61 % për ciklin e dytë, (referuar VKM nr.41 datë 24.01.2018, i ndryshuar me VKM 185, dt 25.03.2021).</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Shih: Nën/Dosja (C) Dosja e plotë Didaktike,</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimorë.</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe takimi me studentët rezulton se ato kanë të planifikuar në programin e studimit një semestër të veçantë për realizimin e diplomës (semestri i dytë, viti i dytë). Gjithashtu evidentohet se ky program studimi parashikon për realizimin e diplomës dhe aktiviteve kërkimore 150 orë të zhvilluara në auditor dhe 300 orë punë individuale e pavarur e studentit, pra 450 orë pune në total që korrespondojnë me 18 kredite CTS.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Dosja e plotë Didaktike</i></p>

Thuriti



	<p><i>Aneks 3.13 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes të diplomave.</i></p> <p><i>Aneks 2.38 Udhëzuesi i Diplomave,</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë, si njësi kryesore e organizuar sipas ligjeve për organizimin akademik dhe administrativ të institucioneve të arsimit të lartë ka si pjesë të saj njësinë bazë përgjegjëse, Departamentin e së Drejtës Publike. Gjatë takimit me përgjegjësen e Departamentit dhe antarët e departamentit, GVJ konstatoi se njësia bazë ngre grupin e vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij, si dhe në linjë me statutin dhe rregulloren e institucionit. Kjo njësi përmbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi duke respektuar ligjet në fuqi.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2. 03 Vendim Rektori, nr. 101 Prot, datë 09/12/2021, "Për miratimin e Grupit të Vetëvlerësimit të Brendshëm, për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale"</i></p> <p><i>Aneks 2. 05 Rregullore e Fakulteti, neni 4.</i></p> <p><i>Aneks 2.08 Rregullore Departamentit të së Drejtës Publike, neni 4 dhe 8 pika "f".</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë ka në përbërje tre njësi bazë;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i së Drejtës Publike; 2. Departamenti i së Drejtës Private; 3. Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë/FD; <p>Departamenti i së Drejtës Publike ofron studime në katër programe, një diplomë profesionale, një program të ciklit të parë,</p>


Therita

	<p>një program të ciklit të dytë dhe një program i integruar i ciklit të dytë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor i Asociuar” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “Doktor i Shkencave”.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statutin e KU “Wisdom”, neni 13.</i></p> <p><i>Aneks 1 02 Rregullore e KU “Wisdom” Kreu III, Organizimi dhe funksionimi i organeve drejtuese akademike të KU “Wisdom”, Nenet 11 deri 25</i></p> <p><i>Aneks 2.22.3 Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Fakultetin e Drejtësisë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë për vitin akademik 2021- 2022 ka gjithsej 25 pedagogë gjithsej, nga të cilët 22 janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 3 janë personel akademik me kontratë (PAK).</p> <p>Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2021-2022:</p> <p><u>Departamenti i së Drejtës Publike:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 PAE, ndër të cilët 5 me tituj / grada; - 1 PAK, ndër të cilët, 1 me tituj / grada; <p><u>Departamenti i së Drejtës Private:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada; - 2 PAK, ndër të cilët 2 me tituj / grada; <p><u>Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë/FD</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 8 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada; <p>Ndërsa stafi akademik i Departamentit të së Drejtës Publike që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (7 PAE / 1 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 4 / 1;</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, (7 PAE/ 1 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 3 / 1;</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022, (7 PAE / 1 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 5 / 1;</p>

Thirti 

	<p>Për sa më sipër Njësia kryesore (FD) dhe njësia bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2. 13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike.</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat, (Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit).</i></p> <p><i>Aneks 2.22.6.Të dhëna Tabelore për personelin akademik</i></p> <p><i>Aneks 2.16.8 Model /template, Formular të kërkimit shkencor</i></p> <p><i>Aneks 2.23.1 CV e stafit akademik të programit të studimit,</i></p> <p><i>Aneks 2.22.6 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i së Drejtës Publike, përgjegjëse për Programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin e studimit, janë të përcaktuara në statutin e institucionit dhe janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor i Asociuar” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “Doktor i Shkencave”. Përgjegjësi i departamentit është autoriteti më i lartë për njësinë bazë mësimore dhe shkencore. Kandidatura e tij përzgjidhet nga trupi akademik i brendshëm i departamentit dhe emërohet nga Dekani i FD.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statutin e KU “Wisdom”, neni 28.</i></p> <p><i>Aneks 1 02 Rregullore e KU “Wisdom” neni 22.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” neni 8-9.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të DVV rezulton se Departamenti përmban në strukturën e tij. Personel ndihmës akademik 14 (PNA) dhe Personel ndihmës akademik me karakter mësimor 3. Këto janë të përfshirë kryesisht në mbështetje dhe ndihmë të mbarëvajtjes së procesit mësimor. Personeli ndihmës akademik përbëhet nga staf me kohë të plotë, në ndihmë për realizimin e praktikave mësimore, projekteve studimore e kërkimore etj Në rregulloret përkatëse janë të parashikuara objektivat, detyrat dhe funksionet</p>

Thurta



	<p>e tyre. Në shërbim të praktikës mësimore, departamenti bashkëpunon me Qendrën Klinika Ligjore “Wisdom”.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1 02 Rregullore e KU “Wisdom” nenet 122 dhe 114.</i></p> <p><i>Aneks 1.07 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të KU “Wisdom”.</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione</i></p> <p><i>Aneks 4.15. Relacion nga Qendra Klinika Ligjore “Wisdom”.</i></p> <p><i>Aneksi 3.10 Vendim nr. 96 Prot, dt. 07.12.2021, “Për kryerjen e praktikave mësimore ne Fakultetin e Drejtësisë, Për vitin akademik 2021-2022. Bashkëlidhur lista e studentëve dhe pedagogët mbikëqyrës, si dhe model /template formular i vlerësimit të studentit praktikant.</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Sikundërse referohet në RVB, Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit ka caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij. Nga diskutimet e bëra me koordinatorin e këtij programi gjatës vizitës në Institucion, GVJ konstaton se mes koordinatorit të programit të studimit dhe drejtuesit të departamentit, ka një bashkëpunim të vazhdueshëm që ndihmon të dyja palët në vendimmarrje të përditshme. Si pjesë e organizimit brenda departamentit funksionon dhe Grupi mësimor kërkimor (GMK) të cilët kontribuojnë në realizimin e programit të studimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.13.1 Vendimi për caktimin e Koordinatorit të programit të studimit.</i></p> <p><i>Aneks 2.13.2 Relacion i Koordinatorit të Programit të Studimit (shembull.)</i></p> <p><i>Aneks 2.33 Vendim emërimi të Përgjegjës të Departamentit të së drejtës Publike.</i></p> <p><i>Aneks 2.34 Vendim emërimi të Përgjegjësi i grupit mësimor-kërkimor.</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021. nr. 469 Prot, datë 29/10/2021.</i></p>
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Koordinatori i programit referuar informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion realizohet në vijimësi. Ai raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse. Në lidhje me çdo informacion që lidhet me programin e studimit, kordinatori bën relacionin me shkrim lidhur me procesin mësimor dhe mënyrën e realizimit të tij nga cdo pedagog.</p>

Thurtu

<i>Aneks 2. 13.2 Relacion i Koordinatorit të Programit të Studimit</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në diskutimet e kryera me pedagogët e programit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se informacionet për elementet e rëndësishme të programeve të studimeve bëhen publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht. Në Statutin dhe Rregulloren e institucionit si dhe në rregulloren e Programit janë përcaktuar qartë informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxëniet, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat punësimit, etj.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.08 Rregullore Departamentit të së Drejtës Publike, nenet 8 dhe 9.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", kreu III.</i></p> <p><i>Nën/Dosja (C) Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar planit mësimor të programit të studimit, konstatohet se është i organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, dhe VKM 41, dt.24.01.2018. Programi mësimor përmban 120 ETCS të ndarë në dy vite mësimore, me 2 (dy) semestra në çdo vit, me ngarkesë prej 60 ETCS në çdo vit mësimor. Çdo lëndë vlerësohet me kredite, çdo lëndë ka të përcaktuara orët javore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Për sa më sipër GVJ konstaton se programi i studimit përmbush kriterin për të qenë i konkurrues për nga elementët e përmbajtjes dhe se synon që studentët në përfundim të studimeve të zotërojnë kompetencat të cilat janë të pasqyruara në Rregulloren e Studimeve.</p>

Thur

	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Dosja e plotë Didaktike.</i></p> <p><i>Aneks 2.22.8 Të dhëna Tabelore për ngarkesën totale në auditor të studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton se programi Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është i organizuar në 4 semestra me një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike. Çdo vit akademik është i përbërë nga 2 semestra me ngarkesë mësimore prej 60 ECTS secili vit; në total 120 ECTS. <i>Aneks 3.03 Plani Mësimorë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit MSc. në “E Drejtë Penale”, respekton të gjitha kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara me ligji (Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018), duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ky program studimi ka një informacion të detajuar konform rregullave në fuqi dhe një shpërndarje të qartë të planit mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas semestrave akademike. Në funksion të këtij procesi është dhe rregullorja e këtij program studimi, në të cilën specifikohen rregullat e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlersimit të dijeve.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimorë.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e programit ka të specifikuar kriteret që duhet të plotësohen për t’u pranuar në programin e studimit. Rregullorja e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Institucioni përmes njësisë të saj monitoron respektimin e kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit në këtë program studimi si dhe procedurat e ndjekura në pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e programit të studimit bazuar në rregulloren e rregjistrimeve dhe transferimeve të KU “Wisdom”.</p>

Thurati

	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom", neni 56.</i></p> <p><i>Aneks 2.09 Rregullore e transferimeve</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Referuar planit mësimor kemi një ndarje të lëndëve mësimore në semestra duke respektuar peshën e ngarkesës në semestra dhe duke ruajtur numrin e krediteve për çdo semestër akademik. Lidhur me procedurat që ndjek institucioni në drejtim të realizimit të programit të studimit kemi një informacion të pasur me të dhëna që rregullojnë punën në drejtim të hartimit të syllabuseve të lëndëve sipas ligjeve shtetërore dhe sipas formatit të miratuar nga MASR. Syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve, ngarkesën javore si dhe detyrimet lëndore.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike.</i></p> <p><i>Annex 3.08 - Annex 3.08.10 Curricula (syllabi).</i></p> <p><i>Annex 3.08- Annex 3.08.17 Curricula (syllabi).</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimor</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Referuar RVB dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe më konkretisht nga Dosja e plotë Didaktike (Nën/Dosja (C)), GVJ konstatoi se programi i çdo lënde hartohet në mënyrë të tillë që të shmangin përsëritjet e informacionit në lëndë të ndryshme. Gjatë takimit me stafin pedagogjik, në vizitën në institucion, stafi ka referuar se përditëson në mënyrë periodike literaturën, në përditësimin e tyre vlejné edhe rekomandimet e ndryshme që vijnë nga mbledhjet e Departamentit, si dhe nga raporti vjetor i NjSBC-së. Ndryshimet në planin mësimor miratohen me Vendim të Senatit Akademik. Dokumentacioni gjendet i arkivuar dhe në faqen e internetit, dhe arkivohet dosja e plotë në gjuhët shqip dhe anglisht. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV-së rezulton se përmirësimi dhe modifikimi i kurrikulës ndodh çdo vit, kryesisht duke futur koncepte dhe njohuri mbi praktika të reja e inovatore.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p>

Thurati

	<i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënljore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit të ciklit të dytë Msc. në “E Drejtë Penale” reflekton një koherencë me parashikimet e akteve ligjore referuar numrit të krediteve, 60 kredite, kohëzgjatjes normale të tij në 2 vite akademike, tipologjisë së lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM.Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregulloren e KU “Wisdom”.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, nenet 17-24.</i></p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Aneks 1.01 Statuti KUW (Alb).</i></p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore KUW (Alb).</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në RVB, dokumentacionin e depozituar për programin mësimor, GVJ konstaton se, emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve janë hartuar duke mbajtur parasysh informimin sa më të mirë të studentit, pasi përmbajnë të gjitha elementët e kërkuara të përfshira në syllabuset e lëndëve/moduleve e të aktiviteteve formuese. Një pjesë e lëndëve janë të ndara në module. GVJ</p>

Thurthi

	<p>konstaton se ngarkesa e programit të studimit, përmbajtja e përgjithshme e moduleve dhe transmetimi i njohurive lehtësojnë formimin teorik dhe praktik të studentëve në funksion të punësimit të tyre. Gjithashtu, praktikat mësimore dhe lëndët zgjerojnë mundësinë e përfshirjes së studentëve në tregun e punës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" nenet 18-24.</i></p> <p><i>Shih: Aneks 2. 10 Studimi i Tregut.</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në RVB, dokumentacionin e depozituar (<i>Dosja e plotë Didaktike</i>), rezulton se shpërndarja e lëndëve/ moduleve gjatë viteve dhe në 4 semestra synon thellimin e njohurive në fusha specifike. Shpërndarja është e balancuar dhe kalon natyrshëm nga lëndët formuese në ato më specifike që ndihmon studentin të formëzohet. Plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi, dhe ndarja e peshës akademike e përkthyer në kredite për secilën prej tyre mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin akademik. Lëndët që përbëjnë planin mësimor për programin e studimit mundësojnë integrimin e informacionit duke qenë se ato kanë lidhje me njëra-tjetrën në një masë të caktuar që e lehtëson këtë proces. truktura dhe organizimi i programit dhe planit mësimor kanë logjikë ndërdisiplinore, duke nxitur angazhimin e tyre në kërkim shkencor, studim të mëtejshëm të disiplinave të cilat ju ofrohen përgjatë programit të studimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", nenet 17-24.</i></p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike,</i></p> <p><i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master</p>	<p>Referuar të dhënave të shqyrtuara nga GVJ struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale". Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në</p>

Thurati



<p>dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>kategoritë: Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 8 % (10 ECTS); Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 53 % (64 ECTS); Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore / Integruese 10 % (12 ECTS); Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (12 ECTS); Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 15 % (18 ECTS). Ky program studimi respekton të gjitha kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, nenet 17-24.</i></p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021. nr. 469 Prot, datë 29/10/2021.</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Dosjes së plotë Didaktike, GVJ konstaton se, ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë mobilitet në kuadër të projekteve si Erasmus +, në drejtim të përafrimit të këtij programi studimi me programet e tjera të ngjashme që zhvillohen në vendet e BE-së si dhe objektivave strategjike të KU “Wisdom”. Bazuar në rolin që çdo disiplinë mësimore ose veprimtari formuese luan në formimin e studentit, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A deri në E. Në RVB përmendet ndarja rreth 61 % për lëndët e kategorisë A dhe B. Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimit me stafin akademik dhe specialisten e zyrës së Karrierës dhe jetës studentore konfirmojnë mundësinë dhe lehtësimin në transferimin e studentëve nga programe të tjera studimi</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Aneks 1. 14 Strategjie Kërkimit Shkencor, projekteve, Partneriteteve e mobilitetit ndërkombëtar.</i></p> <p><i>Aneks 2. 09 Rregullore e transferimeve</i></p> <p><i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i></p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të</p>	<p>Referuar DVV dhe takimeve me stafin akademik, rezulton se syllabuset përditësohen vazhdimisht, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Ndërkohë sugjerimet dhe</p>

Thuriti

<p>vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>rekomandimet e ndryshme vijnë edhe nga raportet e hartuara nga NJSBC në lidhje me programet apo procesin mësimor, sipas përcaktimit të bërë rreth literaturës në VKM 41, 24.01.2018, (ndryshuar).</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Aneksi 3.09.1 Shembull i një syllabusi të përditësuar ndër vite.</i></p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC</i></p> <p><i>Aneks 2 19.4 Relacion i pyetësorëve të studenteve të FD.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Mënyra sesi janë ndërtuar modulet e lëndëve të japin mundësi për fitimin e shprehive shkencore dhe profesionale. Vetë ndarja e lëndëve / moduleve sipas përcaktimit të kërkuar nga aktet ligjore në fuqi, kombinuar me të nxënit jashtë auditorit dhe praktikën mësimore bëjnë të mundur garantimin e përfitimit të dijeve, të synuara në këtë program studimi. Në fund të studimeve, studenti i diplomuar përmbush kriteret e vlerësimit si specialist në fushën e së Drejtës Penale, me aftësi dhe kompetencë profesionale për të adresuar çështje praktike dhe të detyrave institucionale në vendin e punës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, Kreu II.</i></p> <p><i>Aneks 3.08 Programet mësimore (syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në analizën që GVJ i bëri Dosjes së plotë didaktike, si dhe pasi u njoh me zbatueshme rinë gjatë vizitës në institucion, rezultoi se programi i studimit përmban lëndë të emërtuara dhe kategorizuara për tu krijuar studentëve mundësinë për studime të tjera më të thelluara. Presa i përket njohurive, mund të pohojmë se ky program i pajis studentët me njohuritë specifike në fushën juridike të së drejtës penale dhe aftësinë për implementimin në praktikë të njohurive të fituara gjatë studimeve. GVJ konstaton se nga ky program janë punësuar student në institucione qendrore dhe vendore si dhe në kompani private. Nga ana e Specialistit të këshillimit të karrierës dhe jetës studentore, sigurohen studime tregu, të cilat harton me daljen e brezave të studentëve. Gjatë diskutimeve u evidentua se Strukturat përgjegjëse të institucionit konsultohen</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Bazuar në analizën që GVJ i bëri Dosjes së plotë didaktike, si dhe pasi u njoh me zbatueshme rinë gjatë vizitës në institucion, rezultoi se programi i studimit përmban lëndë të emërtuara dhe kategorizuara për tu krijuar studentëve mundësinë për studime të tjera më të thelluara. Presa i përket njohurive, mund të pohojmë se ky program i pajis studentët me njohuritë specifike në fushën juridike të së drejtës penale dhe aftësinë për implementimin në praktikë të njohurive të fituara gjatë studimeve. GVJ konstaton se nga ky program janë punësuar student në institucione qendrore dhe vendore si dhe në kompani private. Nga ana e Specialistit të këshillimit të karrierës dhe jetës studentore, sigurohen studime tregu, të cilat harton me daljen e brezave të studentëve. Gjatë diskutimeve u evidentua se Strukturat përgjegjëse të institucionit konsultohen</p>

Thurati

	<p>dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2. 10 Studimi i Tregut.</i></p> <p><i>Aneks 1.09 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, neni 13 deri 25.</i></p> <p><i>Aneks 1.14 Strategjie Kërkimit Shkencor, projekteve, Partneriteteve e mobilitetit ndërkombëtar.</i></p>			
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Programi mësimor dhe mënyra e ndërtimit të kurrikulës së këtij program studimi krijojnë mundësi për vijimin e zhvillimit të kompetencave shkencore e profesionale në analizën, ndërhyrjen dhe zgjidhjen e problemeve të ndyshme. Ndërthurja e njohurive dhe shprehive të kërkimit shkencor me ato profesionale që synohen të përvetësohen përmes programit të studimit Msc. në “E Drejtë Penale do t’i ndihmojë studentët të zotërojnë asetet e nevojshme të pritshme nga punëmarrësit e tyre.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Aneks 2. 10 Studimi i Tregut.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Ngjyrosje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë katër viteve akademike është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022 janë të angazhuar 11 pedagogë ndër të cilët 9 PAE dhe 2 PAK.</p>

Thurta

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Mbulimi i programit në përqindje është **90% PAE dhe 10% PAK.**

Për vitin akademik **2020-2021** janë të angazhuar **11** pedagogë ndër të cilët **10 PAE dhe 1 PAK.**

Mbulimi i programit në përqindje është **90% PAE dhe 10% PAK.**

Për vitin akademik **2019-2020** janë të angazhuar **11** pedagogë ndër të cilët **10 PAE dhe 1 PAK.**

Mbulimi i programit në përqindje është **90% PAE dhe 10% PAK.**

Për vitin akademik **2018-2019** janë të angazhuar **9** pedagogë ndër të cilët **8 PAE dhe 1 PAK.**

Mbulimi i programit në përqindje është **90% PAE dhe 10% PAK.**

Për sa i përket kualifikimeve të Personelit akademik:

- Për 2021-2022, 70% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik;
- Për 2020-2021, 70% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik;
- Për 2019-2020, 80% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik;
- Për 2018-2019, 90% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik;

Referuar dokumentacionit të konsultuar më sipër si dhe CV-ve të stafit akademik dhe programit mësimor, GVJ konstaton se për të katër vitet akademike, 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022 programi, përmbush kërkesën ligjore për stafin akademik efektiv, që mbulon jo më pak se 70 % ngarkesën mësimore sipas (VKM 418, Maj 2017). Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në DVV, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, kualifikimet e tyre akademike dhe eksperiencia e gjatë në mësimdhënie, është në përputhje me natyrën dhe specifikën e lëndëve/ moduleve të programin e studimit, ku janë të përfshirë.

Thurta

	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statuti i KU "Wisdom" neni 45. "Punësimi i personelit akademik"</i></p> <p><i>Aneks 2.23.1 CV e stafit akademik të programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks 2.22 Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik</i></p> <p><i>Vizita në institucion por edhe nga RVB.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit institucional që KU "Wisdom" ka nënshkruar për qëllime të zhvillimit të praktikës, shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore janë faktor kyç për profilin e juristit me drejtim specifik fushën penale. Referuar RVB marrëveshjet janë të lidhura me institucione të ndryshme të nivelit qendror dhe vendor dhe kompani private, me qëllim kryerjen e praktikës mësimore në semestrin katërt të studimeve (12 kredite 300 orë). Studentët janë të përfshirë në mënyrë aktive edhe përmes Qendrës Klinika Ligjore "Wisdom", jo vetëm në trajnime por dhe në detyra konkrete të këshillimit ligjor, por Klinika ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë e cila ka aktivizuar studentët e FD në internship-e dhe praktika mësimore. Nga takimet në Institucion përfaqësues të këtij të fundit u shprehën për GVJ se njëkohësisht NjKSH&MJ ka dhënë kontributin e saj në thellimin e bashkëpunimit me IAL brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu Përgjegjësi i Departamentit përcakton pedagogët përgjegjës për ndjekjen e studentëve në zbatimin e praktikës mësimore. Pedagogu përgjegjës ndjek zbatimin e praktikës mësimore. Progresi i punës së studentit monitorohet nga institucioni pritës dhe Fakulteti. Në fund studentit paraqet një formularë të plotësuar dhe vulosur dhe prezanton detyrat e kryera/të përmbushura. GVJ konstatoi se këto elemente vlerësoheshin maksimalisht nga studentët.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.30.4 Informacion mbi grantet e përfituara në kuadër të pjesëmarrjes në programe Erasmus+ për vitet 2014-2020.</i></p> <p><i>Aneks 2.30.1 Shkresë mbi aktivitetin me të fuar në kuadër të implementimit të marrëveshjes me CILS.</i></p> <p><i>Aneks 4.15 Relacion nga Qendra Klinika Ligjore "Wisdom".</i></p>

Thirti

	<p><i>Aneksi 3.10 Vendim nr. 96 Prot, dt. 07.12.2019, "Për kryerjen e praktikave mësimore ne Fakultetin e Drejtësisë, Për vitin akademik 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NjKSH&MJ.</i></p> <p><i>Aneks 1.14 Strategjia Kërkimit Shkencor,</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Sipas RVB Institucioni siguron realizimin e procesit mësimor përmes angazhimit të personelit akademik, atij ndihmës mësimor dhe shkencor si dhe personelit mbështetës dhe administrativ. Për përmbushjen e qëllimit dhe objektivave didaktike në nivel institucioni rezulton se ekzistojnë struktura përgjegjëse (IT) që merren me mirëmbajtjen e infrastrukturës, përdoren laboratorë e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.28 Planimetria dhe kontratë qiraje.</i></p> <p><i>Aneks 2.28.1 Planimetria e mobiluar</i></p> <p><i>Aneks 2. 27 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit..</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe referuar RVB, GVJ konstaton se mundësia e njohjes me kërkesat e tregut të punës rezulton se realizohet përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të institucionit, për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve. Gjithashtu kordinimi i punës midis njësisë kryesore, asaj bazë dhe rolit të kordinatores së programit të studimit, krijojnë një infrastrukturë të përshtatshme për mbarëvajtjen e punës në</p>

Thuriti

	<p>këtë program studimi. Në drejtim të bashkëpunimit me partner nga tregu i punës ka një ndëveprim të drejtpërdrejt me profesionistët e terrenit në kontekstin e praktikës profesionale. GVJ konstaton se programi i studimit në pesë vitet e fundit objekt shqyrtimi rezulton të ketë rreth 75.5% nivelin e punësimit të të diplomuarve, referuar në analizën vjetore të paraqitur nga NJKSH&MJ.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.26.1 Informacion mbi Studentët e Diplomuar</i></p> <p><i>Aneks 2. 10 Studimi i Tregut.</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NjKSH&MJ</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në takimin me stafin akademik është shprehur drejtpërsëdrejti interesi dhe përpjekja për të përmirësuar programin e studimit, duke inkurajuar dhe përfshirë në diskutime edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet dhe opinionet e tyre diskutohen në nivel Departamenti dhe Fakulteti dhe nëse janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit gjejnë reflektim në programet e studimit. Në takimet me drejtuesit e njëzisë bazë, GVJ u informua se njëzia bazë organizon takime periodike me studentët për të marrë feedback-un e tyre për mënyrën e realizimit të programit mësimor dhe aspektin e realizimit të eksperiencave të praktikës profesionale pranë institucioneve me të cilat KU “Wisdom” ka një marrëveshje.</p> <p>Nga ana tjetër, gjatë takimeve me përfaqësues të Institucionit u konfirmua një fakt i hasur edhe në dokumentin e DVV, që Departamenti i cili ofron këtë program studimi zhvillon mbledhje të hapura për studentët e programit, me qëllim që ata të kenë mundësi të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit por edhe për problematika të tjera të hasura.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.32 Vendimet e emërimit të organeve drejtuese në KU “Wisdom” në të cilat studentët gëzojnë statusin e anëtarit me të drejta të plota.</i></p> <p><i>Aneks 2.26.9 Relacion i takimit me Alumnin.</i></p>

Thurati

<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren një fokus të qartë në mbajtjen e lidhjeve me studentët e diplomuar Alumni. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës së tij formative për të qenë sa më afër pritshmërive dhe kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.32 Vendimet e emërimit të organeve drejtuese në KU "Wisdom" në të cilat studentët gëzojnë statusin e anëtarit me të drejta të plota.</i></p> <p><i>Aneks 2.26.1 Informacion mbi Studentët e Diplomuar.</i></p> <p><i>Aneks 2.26.9 Relacion i takimit me Alumnin.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se institucioni në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, homologe, përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike të studimit dhe kërkimit. Nga shqyrtimi i RVB dhe i dokumenteve në DVV, si dhe nga takimet në terren u konfirmua fakti se departamenti i së drejtës publike, ka aplikuar për hapjen e programit "Bachelor në shkencë krimnologjike dhe investigative", i cili e plotëson kuadrin e studimeve nga Bachelor në Master të shkencave në "E Drejtë Penale".</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.7</p>	
<p>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Mbështetur në shqyrtimin RVB dhe konfirmuar nga vizita në Institucion, GVJ konstaton se programi i studimit Master Shkencor në "E Drejtë Penale", ka të përcaktuar qartë objektivat mësimore dhe kërkimore shkencore të tij të shprehura në dokumentacionin bazë të institucionit si në statutin e KU "Wisdom", ku shprehet se qëllimet dhe misioni i këtij programi studimi është në koherencë me atë të institucionit në tërësi.</p>


Thuriti 

	<p>Programi formon dhe kualifikon specialistë të fushës e drejtësisë.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statuti i KU "Wsdom" nenet 3-4.</i></p> <p><i>Aneks 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit i KU "Wisdom" 2018-2023.</i></p> <p><i>Aneks 2.11 Plani Strategjik 2018-2023 Për Programin e Studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Sipas Planit Strategjik të Zhvillimit të KU "Wisdom" dhe Plani Strategjik për Kërkimin Shkencor në periudhën 2021-2026, rezulton se detyrat institucionale të Departamentit përgjegjës janë përfshirë në një sërë fushash të kërkimit shkencor. Njësia kryesore/bazë nxit dhe ka një rol aktiv në drejtim të bashkërendimit dhe administrimit të veprimtarive në mësimdhënie. Në këtë aspekt janë ndërmarrë një sërë nismash që kanë ndikim pozitiv si në zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik por edhe tek studentët e këtij program studimi. Mënyra e realizimit të procesit mësimor dhe autonomia që secili pedagog ka në drejtim të realizimit të programit mësimor të lëndës së tij kryhen duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit i KU "Wisdom" 2018-2023.</i></p> <p><i>Aneks 2.07 Raporti vjetor i KU "Wisdom", VA 2020-2021, fq 56-63</i></p> <p><i>Aneks 1.14 Strategjie Kërkimit Shkencor, projekteve, Partneriteteve e mobilitetit</i></p> <p><i>Aneks 1.15 Raport Vjetor i Monitorimit dhe Sigurimit të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë i mundëson studentëve të angazhohen në veprimtari që nxisin mendimin kritik dhe të angazhohen në thellim të mëtejshëm të disiplinave akademike. Gjithashtu vlen të theksohet se lëndë të veçanta kanë të përfshira edhe detyrat e kursit në të cilat studentët fillojnë të zhvillojnë aftësi në drejtim të hulumtimeve që bazohen tek shqyrtimi i literaturës. Rreth 15% e totalit të krediteve të programit të studimit i janë dedikuar punimit të diplomës, gjë që nxit studentët të përfshihen në studime të thelluara akademike-shkencore. Gjithashtu sikurse referohet në RVB por u vërtetua edhe gjate takimeve me NjKSH&MJ e cila në bashkëpunim me Departamentin dhe Qendrën Klinika Ligjore "Wisdom" kanë organizuar Konferenca Ndërstudentore.</p>

Thuriti

	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.07 Raporti vjetor i KU "Wisdom", VA 2020-2021, fq 66-69.</i></p> <p><i>Aneks 1.14 Strategjie Kërkimit Shkencor, projekteve, Partneriteteve e mobilitetit</i></p> <p><i>Aneks 4.07 Botimet e Revistës Shkencore Wisdom</i></p> <p><i>Aneks 4.16 Aplikime dhe projekte nga IKZH Wisdom.</i></p> <p><i>Aneks 2.30.4 Informacion mbi grantet e përfituara në kuadër të pjesëmarrjes në programe Erasmus+ për vitet 2014-2020.</i></p> <p><i>Aneks 2.26.6 Relacion për pjesëmarrjen e studentëve KU "Wisdom" në trajnim, në kuadër të projektit Erasmus+, Nr. 290 prot, datë 02/03/2020.</i></p> <p><i>Aneks 2.26.7 Relacione mbi aktivitetet studentore ndër vite.</i></p> <p><i>Aneks 2.26.8 Relacion të takimit online me partnere dhe bashkëpunëtorë të FD.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Bazuar në angazhimet e stafit akademik dhe të institucionit KU "Wisdom" në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare janë element që ndikojnë pozitivisht në drejtim të plotësisimit të këtij kriteri. Roli i tyre në këto projekte ka për qëllim kryesor zgjerimin, thellimin, zbatimin e njohurive shkencore mbi fenomenet e studiuara në planin e rritjes së cilësisë në mësimdhënie e në drejtim të kërkimit shkencor. Programi i studimit përfiton nga veprimtaritë e ndërmarra nga institucioni në kuadër të zhvillimit të një sër projektsh. Pedagogët e këtij program studimi janë pjesë e angazhimeve akademike dhe më gjerë për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të politikave studimore e shkencore.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.07 Botimet e Revistës Shkencore Wisdom</i></p> <p><i>Aneks 4.16 Aplikime dhe projekte nga IKZH Wisdom.</i></p> <p><i>Aneks 4.17.1 Relacion për personelin akademik të angazhuar në programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni. Sipas dokumentacionit të DVV rezulton se, Institucioni zotëron burime të mjaftueshme dhe të qëndrueshme financiare. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë dhe strukturat e tjera janë partner në një sër projektsh si Erasmus +, përmes të cilit krijohen mundësi për</p>

Thurta




	<p>shkëmbim të praktikave të mira në trajnime, leksione të hapura, mobilitete në mësimdhëne për stafin akademik dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. Gjithashtu institucioni mbështetet financiarisht stafin akademik përmes mështetjes për publikime shkencore në revista kombëtare dhe ndërkombëtar e pjesmarrje në konferenca shkencore.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.29.6 Kriteret për alokimin e fondit vjetor të kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.4 Propozim “Për miratimin e fondi të veprimtarive kërkimore shkencore për VA 2021-2022, të Departamentit të së Drejtës Publike”.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.5 Vendim i Administratores së Sh.p.k “Wisdom”, Për mbështetjen e veprimtarive kërkimore shkencore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8	
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe në mbështetje të dokumentit të DVV, (<i>Vendim për ngritjen e grupeve kërkimore-shkencore, NJKSH&MJ</i>), GVJ konstaton se institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p> <p>GVJ u njoftua edhe gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët, se Institucioni përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka realizuar me institucionet partnere ka mbështetur mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve. Me angazhimin dhe kontributin e grupeve kërkimore, janë realizuar disa aktivitete kërkimore shkencore, leksione të hapura, workshope, seminare, aktivitete rreth fushës së studimit, pjesëmarrje në projekte, botimi i Revistës Shkencore Wisdom dhe Proceedings të Konferencave etj.</p>

Thirti

	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar.</p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione.</i></p> <p><i>Aneks 2.07 Raporti vjetor i KU "Wisdom", VA 2020-2021, fq 66-69.</i></p> <p><i>Aneks 2 19.7 Vendim për ngritjen e grupeve kërkimore-shkencore, NJKSH&MJ në FD.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Përfshirja e stafit akademik dhe studentëve të njësisë bazë në një sër projektesh e studimesh me karakter kërkimor shkencor zhvillon dijet dhe kompetencat profesionale të tyre. Projektet ku kanë qenë partner anëtar të stafit akademik janë disa si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - "Fëmijë të sigurt dhe të shëndetshëm" në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOAD), që financohet nga Bashkimi Evropian (BE); - projekti GET START, 2nd Transnational Meeting Tirana, 23-27 Tetor 2017; "Krizat e refugjatëve në Shqipëri dhe si e përballuam situatën!"; - Erasmus+ & GUS Albania.; - "Shmangia e recidivizmin" financuar nga BE, dhe akorduar nga TLAS në partneritet me Fondacionin Qendra Evropiane në Shqipëri dhe zbatuar nga Klinika Ligjore "Wisdom"; <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.07 Raporti vjetor i KU "Wisdom", VA 2020-2021, fq 65 -79</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NJKSH&MJ</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Nga informacionet e marra gjatë diskutimeve me personelin akademik të programit, në vizitën në Institucion, GVJ u bë me dije se, Departamenti i së Drejtës Publike në bashkëpunim me NJKSH & MJ organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentit (<i>Relacion i Analizës Vjetore të NJKSH&MJ. Aneks 4.02</i>) të dhënat për bashkëpunime shkencore në programin e studimit në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, rezulton se mobiliteti i studentëve është 6 student, numri i leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj është 16, numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë</p>

Thertu



	IAL/ jashtë vendit është 14, dhe numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte është 7. Dokumentacioni i shqyrtuar <i>Aneks 2.07 Raporti vjetor i KU "Ëisdrom", VA 2020-2021, fq 65 -79.</i> <i>Aneks 4.03 Relacion Tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e tjera.(Tabela përmbledhëse në 5 vitet e fundit).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Null përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Null përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Thurta 

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV, rezulton se institucioni ka hartuar një sërë rregulloresh për nxitjen e përdorimit të metodave inovatore në mësimdhënie si, Udhëzues për metodat e mësimdhënies dhe didaktika në kohë pandemie, Udhëzuesi Didaktik, Guida e Studentit, Udhëzuesi i karrierës, Udhëzuesin e Praktikave, Udhëzuesi i Diplomave.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.30.2 Trajnimi i stafit akademik me Prof.As. Leticja Gusho.</i></p> <p><i>Aneks 2.35 Udhëzues Didaktik</i></p> <p><i>Aneks 2.36 Udhëzuesin e Praktikave</i></p> <p><i>Aneks 2.37 Metodatat e mësimdhënies dhe didaktika.</i></p> <p>https://eisdom.edu.al/guida-e-studentit</p> <p>https://eisdom.edu.al/udhezuesi-i-karrieres</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ konstatoi se Institucioni në drejtim të realizimit të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative për personelin akademik ka ngritur një strukturë të quajtur Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili punën e tij e bazon në tre dokumenta që janë: Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Sigurimi i cilësisë në nivel departamenti, dhe Strukturës për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Përmes tyre monitorohet puna e personelit akademik dhe ndihmës akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.06 Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i></p> <p><i>Aneks 2.19.2 Plani i NjSBC veprimtarive kryesore për vitin akademik 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneks 2.19.1 Të dhëna për anëtarët e NJBSC. (tabela)</i></p> <p><i>Aneks 4.01 Rregullore NjKSHMJ</i></p> <p><i>Aneks 2.19.6 Politika për garantimin e cilësisë në KU Wisdom</i></p>

Theriu

<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se NjsBC organizon punën në bashkëpunim me njësitë bazë, Komisionin për garantimin e standardeve të cilësisë për të vlerësuar aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik të këtij programi studimi.</p> <p>Përfshirja e studentit në vlersimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët, realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angzhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies. Administrimi i pyetësorit i lejon atyre ruajtjen e anonimatit gjatë dhënies së vlerësimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.06 Rregullore e NjsBC, Neni 9.</i></p> <p><i>Aneks 2.16.3 Model /template, Pyetësori i studentit</i></p> <p><i>Aneks 2.16.4 Model /template, Pyetësori për mbledhjen e opinionëve të pedagogëve.</i></p> <p><i>Aneks 2.16.5 Model /Relacion lënde</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ ka shqyrtuar dokumentacionin dhe ka konfirmuar gjatë vizitës në institucion se Kolegji Universitar “Wisdom” ka hartuar dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Raporti vjetor i monitorimit analizon cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të realizuar në të gjitha njësitë bazë. Raporti i hartuar nga Departamenti shpërndahet dhe diskutohet në njësinë bazë për përmirësimin e punës për vitin e ardhshëm akademik. Institucioni në kuadër të planit strategjik 5 vjeçar harton edhe plani strategjik të zhvillimit të cilësisë si dhe një plan pune të NjsBC-së, e cila harton, raporton dhe publikon në mënyrë periodike rezultatet e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë. Ky mekanizëm shërben për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike</i></p> <p><i>Aneks 1.17 Udhëzues për Monitorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit.</i></p> <p><i>Aneks 1.18 Politika Institucionale e Publikimit të Informacionit.</i></p>

Thurati

<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Nxitja e stafit akademik për zbatimin e praktikave të mira referohet të jetë kryer përmes bërjes publike të rezultateve të anketimit të studentëve dhe përmes rrugëve të tjera si organizimi i leksioneve të hapura për stafin akademik dhe studentët në programin e studimit duke mundësuar nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Institucioni mbështet stafin në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies, që të marrë pjesë në trajnime të ndryshme me tematikë specifike profesionale që lidhen me ndihmën që do t'u jepet studentëve të këtij programi studimi. Nga vizita në institucion rezultoi se të gjithë anëtarëve të personelit akademik u janë krijuar mundësi të barabarta për kualifikim shkencor dhe përfshirje në projekte kërkimore shkencore.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike</i></p> <p><i>Aneks 1.21 Të dhëna nga faqja zyrtare e WEB-it</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konfirmon se personeli akademik i përfshirë në zbatimin e programit të studimit përdor një gamë të gjerë formash të mësimdhënies: leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursi, praktikat mësimore dhe profesionale. Krahas syllabuseve të lëndës/module pedagogët hartojnë Plan Kalendar të lëndës ku përcaktojnë në mënyrë të detajuar të gjitha metodat dhe format që përdorin për çdo temë të veçantë në 15 javët e semestrit. Veprimtaritë e tjera ndihmëse si leksionet e hapura me të ftuar të profilit të këtij programi studimit, konferencat shkencore gjithashtu janë në funksion të diversifikimit të formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>

Thurthi

	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike:</i></p> <p><i>Aneks 2.35 Udhëzues Didaktik</i></p> <p><i>Aneks 2.36 Udhëzuesin e Praktikave</i></p> <p><i>Aneks 2.38 Udhëzuesi i Diplomave</i></p> <p><i>Aneks 3.08 Programet mësimore (syllabuset)</i></p> <p><i>Aneksi 3.09 Model /template/Plan Kalendarë lënde i plotësuar.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion personeli akademik ka konfirmuar se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me një literaturë të 5 viteve të fundit, gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike.</i></p> <p><i>Aneks 1.20 Të dhëna për Platformat online-Struktura e TIK-Biblioteka-Biblioteka online-etj</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar udhëzues për personelin akademik dhe studentët që të zhvillojë aftësitë e veta lidhur me përdorimin e teknologjive të reja të komunikimit përmes udhëzuesve të hartuar si: Udhëzues për metodat e mësimdhënies dhe didaktika në kohë pandemie, Udhëzuesi Didaktik, Guida e Studentit etj</p> <p>NjKSH&MJ kontribuon në thellimin e bashkëpunimit me IAL brenda dhe jashtë vendit, anëtarë të personelit akademik kanë përfutur mobilitete dhe kanë marrë pjesë në aktivitete shkëmbimi, organizimin e përbashkët të aktiviteteve shkencore, marrjen pjesë në projekte të përbashkëta të kërkimit shkencor, kualifikimin e stafëve akademike, kryerjen e kërkimeve individuale, etj. Për sa i përket kualifikimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit të mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, institucioni mbështet anëtarët e stafit akademik duke i përfshirë në projekte dhe trajnime të cilat ndihmojnë në integrimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies.</p>

Murti

	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.07 Raporti vjetor i KU "Wisdom",</i></p> <p><i>Aneks 2.30.2 Trajnimi i stafit akademik.</i></p> <p><i>Aneks 2.30 Shkresë mbi aktivitetin me të ftuar Psh: Phd David Kolb; Prof. Maria Casola.</i></p> <p><i>Aneks 2.30.3 Shkresa mbi aktivitetin me të ftuar në kuadër të implementimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Qendrën CILS, Austri për vitin akademik 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneks 2.30.1 Shkresë mbi aktivitetin në kuadër të implementimit të marrëveshjes me CILS.</i></p> <p><i>Aneks 2.20 Praktikë dokumentacion mobiliteti i stafit akademik (teaching mobility)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Bazuar në kualifikimet e stafit akademik dhe në rezultatet e grumbulluara prej pyetësorëve me studentët, personeli akademik i përfshirë në programin e studimit ka kualifikimin për përfshirjen në mësimdhënie. Stafit mbetet i angazhuar në procesin e kërkimit shkencor me botimin e artikujve shkencorë brenda dhe jashtë vendit. Në pesë vitet e fundit ka botuar artikuj shkencorë brenda dhe jashtë vendit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numri i botimeve nga PAE i Departamentit të së drejtës Publike rezulton të jetë 54 (pesëdhjetë e katër); - Stafit është i përfshirë në zbatimin e projekteve, në shkallë Departamenti/ Fakulteti, numri rezulton të jetë 53 (pesëdhjetë e tre); - Ndërsa numri i projekteve kërkimore të fituara në shkallë Departamenti/ Fakulteti është 26 (njëzet e gjashtë); - Ndërsa numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga Departamenti/ Fakulteti dhe IAL, për programin e studimit është 19 (nëntëmbëdhjetë); - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare në rang Fakulteti/programi studimi në kuadër të Bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit është 14 (katërmëdhjetë); <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale". Neni 17-24.</i></p> <p><i>Aneks 2.16.3 Model /template, Pyetësori i studentit.</i></p> <p><i>Aneks 3 03 Plani Mësimorë.</i></p>

Thirti 

	<p><i>Aneks 3.05 Personeli Akademik /Ngarkesa mësimore</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione, (Tabela përmbledhëse).</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NJKSH&MJ</i></p> <p><i>Aneks 2.22 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit në karakter profesional. (për të gjitha vitet që programi i nënshtrohet vlerësimit).</i></p> <p><i>Aneks 2.23.1 CV e stafit akademik të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Institucion, në takimet me drejtuesit dhe studentët konstaton se Kolegji përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke i përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies. Administrimi i pyetësorit i lejon atyre ruajtjen e anonimatit gjatë dhënies së vlerësimit. Gjithashtu, edhe fokus grupet janë një tjetër formë që institucioni përdor në drejtim të përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të pedagogëve. GVJ-së ju prezantua matja e rezultateve dhe performacës edhe përmes pjesëmarrjes së studentëve në orët e leksioneve dhe të seminareve. Sikundërse u referua pjesëmarrja e lartë është tregues interesi prej studentëve. Nga ana tjetër, takimi me grupin e studentëve konfirmoi përdorimin e teknikave të ndryshme që e bëjnë orën mësimore jo vetëm tërheqëse por edhe më efektive në përthithjen e njohurive dhe nxitjen e mendimit kritik ku personeli akademik është i angazhuar për të nxitur bashkëpunimin mes studentëve .</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneksi 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Aneks 2 19.4 Relacion i pyetësorëve të studenteve të FD.</i></p> <p><i>Aneks 2 19.5 Kalendar i kontrollit e brendshëm, nr. 465 Prot, datë 29/10/2021.</i></p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021. nr.438 Prot, datë 04/10 2021.</i></p> <p><i>Aneks 2.16.3 Model /template, Pyetësori i studentit</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Refruar RVB në këtë program studimi përdoren një larmishmëri formash dhe metodash në mësimdhënie, si përdorimi i vidiave projektorëve, format interaktive të diskutimit, simulimit në seminare, detyra kursi etj. Këto forma ndihmojnë studentin të</p>

Theriti

	<p>fitojë njohuri praktike mbi fushën e drejtësisë. Gjithashtu, nga studentët për pedagogët pati në përgjithësi komente pozitive mbi formën e realizimit të leksionit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.16.3 Model /template, Pyetësori i studentit</i></p> <p><i>Aneks 2 19.4 Relacion i pyetësorëve të studenteve të FD.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Duke u mbështetur në informacionin e marrë nga takimi me studentët dhe pedagogët, por edhe nga rregulloret dhe udhëzimet e institucionit mbi rregullat e ndërtimit të marrëdhënies pedagog –student, respektohet dinjiteti dhe integriteti i çdo studentit. Proçesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies realizohet në një klimë pozitive dhe liria e mendimit respektohet duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë e të menduarit kritik të studentit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.3</p> <p>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Proçesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Infrastruktura e shfrytëzueshme për këtë program studimi është e mjaftueshme, funksionale dhe cilësore për realizimin e objektivave të këtij program studimi. Mësimi zhvillohet në një godinë gjashtë katesh në Autostradën Tiranë-Durrës me një sipërfaqe totale 2000 m². GVJ gjatë vizitës në Institucion, vëzhgoi mjediset në funksion të zhvillimit të programit të mësimin, salla leksionesh dhe mjedise laboratorike të përdorura janë rikonstruktuar vitin e fundit dhe janë në gjendje optimale për zhvillimin e procesit mësimor. Auditorët mësimorë janë të pajisur me sistem ventilimi/ kondicionimi, me pajisje individuale, video-projektorë me mundësi për tu lidhur me laptopë/kompjuter, tabela shkrimi, rrjeti free ëireless. Në Institucion funksionon laborator (Toefl-Ibt), gjithashtu në</p>

Thurku

	<p>laboratorin e informatikës funksionon sistemi SPSS, dhe biblioteka, të cilat mundësojnë akses të lirë në informacion. Hapësira dhe ndriçimi garantojnë një proces mësimor optimal. Objekti ka të instaluar sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit.</p> <p><i>GVJ konstatoi se laboratorët kanë nevojë për shtim të kapaciteteve në raport me numrin e studentëve në këtë IAL, si dhe ju sygjera krijimi i një laboratorit kriminalistik në funksion të cilësisë së programit të studimit, për të cilën na u pohua që është duke u bërë gati nga ana e Kolegjit për vitin e ardhshëm akademik.</i></p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 27 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit</i></p> <p><i>Aneks 2.28 Planimetria dhe kontratë qiraje.</i></p> <p><i>Aneks 2.28.1 Planimetria e mobiluar</i></p> <p><i>Aneks 2.28.2 Certifikatë “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”.</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Ambjentet në mbështetje të procesit mësimor janë brenda standardeve dhe janë funksionale, janë të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, si videoprojektor, sallat e leksionit janë të pajisura me foni dhe internet. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor një laborator informatike, bibliotekën online në Pro Quest.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Institucion konfirmoi se personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike për realizimin e procesin mësimor. Në ambientet e laboratorit të informatikës funksionon sistemi SPSS, si dhe një sistem për kontrollin e plagjiaturës në veprimtarinë kërkimore-botuese si për stafin ashtu dhe studentët. Institucioni përdor platformën “<i>Wisdom Kolegji Universitar</i>” ëëë.smartuniform.education/login/, që mundëson komunikimin interaktiv pedagog-student hedhjen e materialeve didaktike për cdo lëndë. Nga GVJ u konstatua se zyrat e personelit akademik dhe të organeve të tjera drejtuese janë të pajisura me kompjuter dhe logjistikën e nevojshme dhe përdorin emalin zyrtar: (emërmbiemer@ëisdomuniversity.eu).</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p>


Murti
[Signature]

	<p><i>Aneks 1.20 Të dhëna për Platformat online-Struktura e TIK-Biblioteka-Biblioteka online-</i></p> <p><i>Aneks 1.17 Udhëzues për Monitorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit</i></p> <p><i>Aneks 2.28.1 Planimetria e mobiluar.</i></p> <p><i>Aneks 2 18 Print screen, faqe "Portali i Studentit, Materiale Mësimore</i></p> <p><i>Aneks 2.18.1 Print screen, faqe Eësdom Kolegji Universitar</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi që GVJ i bëri DVV (C) dosjes didaktike, dhe në takimin me personelin akademik konstatoi se çdo lëndë e programit të studimit ka literaturën bazë dhe atë të rekomanduar. Ajo ofrohet në formën e librave të shtypur, të cilët vihen në dispozicion të studentëve, gjithashtu literatura ndihmëse ofrohet si informacion dixhital (version pdf, faqe interneti) dhe përmes bibliotekës. Gjatë vizitës në bibliotekë dhe referuar RVB, në fondin e bibliotekës janë rreth 1642 tituj fizikë dhe 3863 copë libra fizikë, si dhe 65162 periodike revista/buletine shkencore në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, fond ky në format hardcopy dhe elektronik. Biblioteka ka krijuar edhe katalogun on-line ProQuest ku ofron anëtarëve të saj mundësinë e të lexuarit, dhe të studiuarit. Bazuar në Planin Strategjik të Institucionit, Biblioteka harton planin për shtimin e fondit të saj me tituj të rinj apo abonime në revista shkencore. të aksesueshme në faqen ëeb http://www.wisdom.edu.al/. Sipas RVB, Revista Periodike Shkencore "Wisdom", del dy herë në vit, kurse revista "Konferenca Kombëtare Shkencore" një herë në vit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 21 Relacion për Bibliotekën e KU "Wisdom", Bashkëngjitur lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë të shtuar vitet e fundit.</i></p> <p><i>Aneks 2 21.1 Abonim revista juridike</i></p> <p><i>Aneks 2 21.2 Marrëveshje Cobiss.al</i></p> <p><i>Aneks 2 21.3 Marrëveshje ProQuest</i></p> <p><i>Aneks 2 21.4 Wisdom press procedurat e krijimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet</p>	<p>Në fondin e bibliotekës janë rreth 1642 tituj fizikë dhe 3863 copë libra fizikë, si dhe 65162 periodike revista/buletine shkencore në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, fond ky në format hardcopy dhe elektronik. Aktualisht Biblioteka e</p>

Thurati

<p>kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Kolegjit është pjesë e sistemit kombëtar bibliografik COBISS.AL të përdorimit të katalogut elektronik online https://al.cobiss.net/. Institucioni disponon Buletinin Shkencor “Wisdom”).</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët kanë në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies platformën elektronike të aksesimit në bibliotekën online të Proquest. Biblioteka elektronike (on-line) Proquest ofron 187.641 tituj total libra online akademik, në format PDF, si: Laë, Philosophy, Business, Literature, English dhe janë të aksesueshme, për studentët e personelin akademik. Ku rreth 184.353 janë Revista Shkencore online. Rreth 163.342 tituj total libra online akademikë janë të aksesueshëm vetëm në fushën e drejtësisë në linkun përkatës.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Institucioni disponon laboratorin e informatikës, ku përdorimi i tyre është dedikuar orëve laboratorike për të gjithë ciklet e studimit me kapacitete deri në 20 studentë. Laboratori është në dispozicion të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Laboratori siguron kushtet mjedisore të përshtatshme dhe pajisjet e nevojshme për aktivitetin laboratorik të testimit. Rrjeti i vënë në dispozicion është i aksesueshëm pa pagesë.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.20 Të dhëna për Platformat online-Struktura e TIK-Biblioteka-Biblioteka online...</i></p> <p><i>Aneks 2 27 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Institucioni ofron për stafin dhe studentët bibliotekat online duke u bazuar edhe në abonimin që ka në platformat online si Proquest, dhe U-library-COBISS për qëllime të shfrytëzimit të literaturës për nevoja të stafit akademik dhe të studentëve. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor laboretorë informatike, bibliotekën online. Sistemi “Microsoft Teams” i cili ka qenë një mjet kryesor i realizimit të procesit mësimor gjatë situatës së pandemisë globale ka bërë të mundur që studentit të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p>

M. Kurti



	<p>wwwcobis.al.</p> <p>https://ebookcentral.proquest.com/lib.central/wisdom/</p> <p>http://portal.hstalb.xyz/teacher/online_exams/</p> <p><i>Aneks 2 21 Relacion për Bibliotekën e KU "Wisdom", Bashkëngjitur lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë të shtuar vitet e fundit.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Sistemi komunikimi i brendshëm realizohet nëpërmjet domain-it zyrtar të KU "Wisdom" emer.mbiemer@wisdom.edu.al.</p> <p>Platforma "Microsoft Teams" ka qenë një mjet kryesor i realizimit të procesit mësimor gjatë situatës së pandemisë globale e cila ka bërë të mundur që studenti të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Pas shqyrtimit të rregulores së programit të studimit rezulton e shprehur se "<i>Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet zhvillimin e tyre. Studentët udhëhiqen nga një pedagog i fushës i cili propozohet nga studenti, dhe më pas miratohet nga Departamenti</i>". Udhëheqësi Shkencor përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollon puna e bërë. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sesionin e rregullt të mbrojtjes së diplomës. Departamenti përpiqet të përputhë interesat e studentëve me drejtimit e punës kërkimore të tij.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.13 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes të diplomave</i></p> <p><i>Aneks 2.16.11 Model /template, Formular aplikimi për temën.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Thurta


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni ka ngritur disa struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie, përmes Zyrës së Kordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, Komisionit të Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë, Kordinatorit të programit të studimit, Zyrës së kurrikulës. Puna e këtyre strukturave synon monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standartet shtetërore dhe ato ndërkombëtare. NJSBC si struktura përgjegjëse për monitorimin e sigurimin e cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore–shkencore. Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë ka ndërmarrë takime me studentët e programit të studimit në lidhje me cilësinë dhe shërbimet e ofruara nga KU “Wisdom.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.6 Politika për garantimin e cilësisë në KU “Ëisdom”</i></p> <p><i>Aneks 1.10 Rregullore e Komisionit për Marrëdhëniet me Studentët, Publikun dhe Koordinimin.</i></p> <p><i>Aneks 1.11 Rregullore e Komisionit për Garantimin e Standardeve të Cilësisë.</i></p> <p><i>Aneks 1.12 Rregullore e Komisionit për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Kurrikulën.</i></p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të Njesisë të kërkimit shkencorë dhe marrëdhënieve me jashtë.</i></p> <p><i>Aneks 2. 07 Raporti vjetor i KU “Wisdom”, VA 2020-2021.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia kryesore dhe ajo bazë në bashkëpunim me zyrën e sigurimit të cilësisë ka ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. GVJ konfirmon se në kuadër të analizës vjetore të punës së Departamentit të së Drejtës Publike dhe përmes pyetësorëve me studentët të organizuar në nivel Kolegji (prej NJSBC) vlerësohet në mënyrë të rregullt, niveli dhe aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik. GVJ në takimin që pati në Institucion u informua mbi procedurën e ndjekur prej kësaj zyre dhe mbi</p>

	<p>shkallën e performancës për çdo lëndë në këtë program. Të dhënat e vlerësimit vihen në dispozicion të përgjegjësit të Departamentit për tu diskutuar më pas me secilin personel akademik.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" Neni 22. Departamenti</i> <i>Aneksi 2 08 Rregullore Departamentit të së Drejtës Publike, Neni 8</i> <i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike</i> <i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC 2020-2021.</i> <i>Aneks 2 19.4. Relacion i pyetësorëve të studenteve të FD.</i> <i>Aneks 2 19.5 Kalendari i kontrollit e brendshëm.</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Reruar RVB por edhe në takimin që pati me stafin akademik GVJ pohon se Kolegji Universitar 'Wisdom' trajnon stafin në vazhdimësi mbi metodat e reja inovative të mësimdhënies. Në raportin e NJKSH&MJ citohet se kualifikimi i stafit akademik është kryer përmes pjesëmarrjes në një numër leksionesh të hapura nga profesor të ftuar, workshope, seminare trajnime brenda dhe jashtë vendit, konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe aktivitete shkëmbimi me institucione homologe jashtë vendit. Tregues i kësaj performance tregojnë edhe botimet të kryer nga stafi akademik.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.22.1 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" (për të gjitha vitet që programi i nënshtrohet vlerësimit).</i> <i>Aneks 2.23.1 CV e stafit akademik të programit të studimit</i> <i>Aneks 2.30.2 Trajnimi i stafit akademik</i> <i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021.</i> <i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të Njësisë të kërkimit shkencorë dhe marrëdhënieve me jashtë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe të trajnimit të stafit akademik janë realizuar disa aktivitete me profesorë të ftuar të huaj dhe vendas. Ndër to mund të evidentojmë trajnime e workshope, konferenca dhe mobilitete të stafit akademik me mbështetjen e programit ERASMUS+. Mundësia për publikim në revistën "Wisdom" dhe pjesëmarrjes</p>

Thurte



	<p>në konferencat që KU "Wisdom" organizon pa pagesë për stafin e tij akademik, tregon një mbështetje nga institucioni.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të Njësisë të kërkimit shkencorë dhe marrëdhënieve me jashtë.</i></p> <p><i>Aneks 2. 11 Plani Strategjik 2018-2023</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik u konstatua se, KU "Wisdom" duke u mbështetur në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie ka realizuar një sërë aktivitete që kishin në fokus trajnimin e stafit në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ti sigurojnë trajnim të vazhdueshëm për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja duke ftuar trajnues/lektorë vendas dhe të huaj.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Referuar RVB dhe gjatë takimit në Institucion, GVJ referon se kualifikimi i stafit akademik është një nga prioritetet e Departamentit të së Drejtës Publike. Sipas rregullores mësimore, Strategjisë së KU "Wisdom", Strategjisë së programit të studimit, Planit Strategjik për Kërkimin Shkencor, personeli akademik dhe ndihmës akademik marrin përsipër sigurimin e vazhdimësisë së programit të studimit, në përmirësim të mësimdhënies dhe në implementimin e metodave të reja duke i përputhur këto kritere me natyrën specifike të programit të studimit. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme. Institucioni organizon në vazhdimësi takime, të formave të ndryshme si trajnime, seminare apo workshop-e që janë në përputhje me nevojat e studentëve dhe merr pjesë në aktivitete të ngjashme të organizuara nga institucione apo organizata të tjera si dhe mban kontakte të pandërprera me institucione bashkëpunuese, me studentet e diplomuar që janë në tregun e punës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom", Neni 33; Neni 34</i></p> <p><i>Aneks 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit i KU "Wisdom" 2018-2023.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.4 Propozim "Për miratimin e fondi të veprimtarive kërkimore shkencore për VA 2021-2022, të Departamentit të së Drejtës Publike".</i></p>


Murtu 

	<p><i>Aneks 2.29.5 Vendim i Administratores së Sh.p.k "Wisdom", Për mbështetjen e veprimtarive kërkimore shkencore.</i></p> <p><i>Aneks 2.37 Udhëzues: Metodave të mësimdhënies dhe didaktikës në kohë pandemike.</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion dhe diskutimit me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, sikundërse u citua, në kuadër të lëndës kanë realizuar trajnime dhe workshope, simulime të situatave, vizita në institucione që kanë lidhje me fushën e së drejtës penale për të lidhur sa më mirë anën praktike dhe atë teorike në funksion edhe të programit të studimit. Në kuadër të analizës vjetore të kryer çdo vit nga njësi bazë për ecurinë e zbatimit të programit të studimit, kryhet vlerësimi i metodave të reja, nëse ka pasur, dhe stimulohet futja dhe përdorimi i tyre kur vlerësohen të efektshme. Pedagogët në fund të çdo lënde dorëzojnë "Relacionin e lëndës", ku pasqyrojnë analizat e efekteve dhe pritshmëritë. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneksi 3.10.2 Organizimi i një Vizite mësimore në institucionin e Policisë Shkencore. Kërkesë dhe vendim nr. 157 Prot, datë 11.01.2022.</i></p> <p><i>Aneks 2.30 Shkresë mbi aktivitetin me të ftuar</i></p> <p><i>Aneks 2.30.1 Shkresë mbi aktivitetin me të ftuar në kuadër të implementimit të marrëveshjes me CILS.</i></p> <p><i>Aneks 2.30.2 Trajnimi i stafit akademik me Prof.As. Leticja Gusho.</i></p> <p><i>Aneks 2.30.3 Shkresa mbi aktivitetin me të ftuar në kuadër të implementimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Qendrën CILS, Austri për vitin akademik 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneks 2.16.5 Model /template, Relacion lënde.</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të Njësisë të kërkimit shkencorë dhe marrëdhënieve me jashtë.</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione, (Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit)</i></p>

Therter

<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Gjatë takimit me përgjegjësin e departamentit, u konstatua se njësia bazë duke u mbështetur në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie ka realizuar një sër aktivitetesh që kishin në fokus trajnimin e stafit, duke u siguruar trajnim të vazhdueshëm për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja duke ftuar trajnues/lektorë vendas dhe të huaj. Në këto programe trajnimi është përfshirë personeli akademik efektiv, duke realizuar/drejtuar procesin trajnues, ose leksionet e hapura. Personeli ndihmës akademik është i angazhuar në implementimin e metodave të reja duke frekuentuar takimet dhe workshop-et e organizuara.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Bazuar në rregulloret e Institucionit, rezulton se Departamenti i së Drejtës Publike, si dhe çdo pedagog në lëndën që mbulon në programin e studimit informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e avancimit akademik (detyrat e kursit, punët laboratorike, detyrime të tjera, provimet), njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme, procedurat e vlerësimit të dijeve, apo punimet e diplomës. Kolegji mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse të institucionit, ku parashikohen: kontrolli i dijës dhe format e testimit, e drejta e studentit për të hyrë në provim, mënyra e zhvillimit të provimit, tezat, Komisioni i provimit, afatet, procesverbali i vlerësimit të studentëve, ankimimi i studenteve, e drejta për përmirësimin e vlerësimit të lëndës, kriteret e kalimit në vitin pasardhës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" KREU IX, Kontrolli dhe vlerësimi i dijës, Neni 79 deri në 94; Neni 114 Sekretaria Mësimore.</i></p>


Thirti 

	<p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", Neni 25-26.</i></p> <p><i>Aneks 1.07 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të KU "Wisdom" Neni 2 Funksionet e sekretarisë mësimore.</i></p> <p><i>Aneks 2.16.9 Model /template, Formular i vazhdueshëm i vlerësimit.</i></p> <p><i>Aneks 2.16.7 Model /template, Formular i vlerësimit të studentit praktikant.</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ pohon se gjatë takimeve në institucion me stafin akademik, praktika e njoftimit të detyrimeve të studentit, metodologjia e vlerësimit dhe përshkrimi i syllabusit të lëndës është detyrim ndaj çdo pedagogu/titullari dhe përmbushet në fillim të procesit mësimor për atë lëndë. E njëjta gjë u pohua edhe nga studentët për informimin nga çdo pedagog në lidhje me organizimi dhe detyrimet e lëndës/modul. Në dispozicion të studentit për këtë procedurë vjen dhe udhëzuesi didaktik.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.35 Udhëzues Didaktik</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", Neni 25-26.</i></p> <p><i>Aneks 2.16.1 Model /template, Teze Kolokiumi</i></p> <p><i>Aneks 2.16.2 Model /template, Teze provimi përfundimtar.</i></p> <p><i>Aneks 3.08 Programet mësimore (syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Sikundërse referohet edhe në RVB dhe konfirmuar prej GVJ gjatë vizitës në institucion, vlerësimi i dijeve realizohet në forma të ndryshme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Vlerësimi i vazhduar përmes kontrolleve të njohurive të marra gjatë procesit mësimor, në periudha të ndërmjetme, përmes praktikës, punë krijuese, punime të ndryshme dhe kolokiume, frekuentimin dhe pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, ushtrime; -Detyrat e kursit, të cilat janë individuale ose në grupe studentësh kjo në varësi të lëndëve, në respekt të lirisë akademike, dhe përmbushen gjatë vitit mësimor; -Testimi përfundimtar, në testin final është me shkrim, me gojë ose në format të kombinuar; <p>Kjo mënyrë vlerësimi është e shprehur në rregulloret e funksionit të institucionit dhe të programit të studimit dhe ju bëhet e ditur studentëve në fillim të programit mësimor.</p>

M. Kurti

	Dokumentacioni i shqyrtuar <i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" Neni 79 dhe Neni 80, Neni 82.</i> <i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", Neni 25-26.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	<p>Sipas DVV dhe verifikimit gjatë vizitës në institucion, Departamenti i së Drejtës Publike si njësi përgjegjëse organizon dhe menaxhon procesin e testimit dhe të vlerësimit të njohurive për programin e studimit. Vlerësimi bëhet me notë sipas sistemit me 10 nota. Vlerësimi ndahet në dy pjesë e përcaktuar në syllabusin e lëndës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i kontrollit të vazhduar të dijës (ese, kolekiume, detyra kursi) që zë 30% të vlerësimit; 2. Provimi përfundimtar me 70% të vlerësimit; <p>E drejta për tu futur në provim vlerësohet nga pedagogu i lëndës pas përmbushjes së detyrimeve të lëndës gjatë procesit mësimor. Testimi i kryer në provimin përfundimtar të lëndës kryhet më shkrim, me gojë ose në mënyrë të kombinuar.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", Neni 25-26</i></p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" KREU IX, Kontrolli dhe vlerësimi i dijës, Neni 89.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme	Nga vizita e zhvilluar në Institucion rezultoi që aktualisht nuk ka sisteme të vlerësimit elektronik (na u deklarua që është projektuar për vitin e ardhshëm). Forma e përdorur është ajo standarde me shkrim. Informimi lidhur me rezultatet e provimit jepen nga

Thurter 

<p>abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>pedagogët e lëndës kur provimi zhvillohet me gojë, nga sekretaria mësimore si dhe nga sistemi Portali i Studentit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, Neni 25-26</i></p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom” KREU IX, Kontrolli dhe vlerësimi i dijes, 89</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Procedura e ngritjes dhe funksionimit të komisioneve të provimit është e përshkruar në rregulloret e institucionit. Komisioni i provimit ngrihet nga përgjegjësi i Departamentit, me të paktën dy anëtarë të stafit akademik, ku njëri është titullari i lëndës/modulit. Të dy anëtarët marrin pjesë në provim dhe vlerësimin e studentit. Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara. Në takimin me stafin dhe studentët nuk u referuan problematika lidhur me këtë mënyrë vlerësimi/kontrolli të dijeve.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom” KREU IX, Kontrolli dhe vlerësimi i dijes,</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Provimet zhvillohen në mënyrë anonime me sekretim duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit. Referuar RVB pohohet se institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel. Rezultatet e provimit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom” KREU IX, Kontrolli dhe vlerësimi i dijes, 79- 94.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, Neni 25-26.</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sikundërse referohet në Raport, GVJ konfirmon se vlerësimi me anë të testimit siguron përfshirjen e opinionit të studentëve në procesin e vlerësimit dhe të kontrollit. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Studenti edhe gjatë vlerësimit dhe kontrollit të dijeve mund të marrë informacion dhe të këshillohet mbi paqartësi që ai ka në lidhje</p>

M. Hoxhi

	<p>me procesin që po zhvillohet me qëllim që të ndihmohet dhe të përmirësohet në të ardhmen.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" KREU IX, Kontrolli dhe vlerësimi i dijes, Neni 84-85-88.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", Neni 25-26.</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ konstaton se Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Vlerësimi i njohurive kryhet përmes testimit, mos lejjimit të personave të jashtëm të futen në provim, respektimin e orarit dhe masave parandaluese për kopjim. Ndërsa lidhur me fenomenin e plagjiaturës KU "Wisdom", ka vendosur në përdorim dhe një sistem për kontrollin e plagjiaturës. Në ambientet e laboratorit të informatikës funksionon edhe sistemi SPSS.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" Neni 69 pika "d" dhe "e".</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion GVJ është informuar se komunikimi i vlerësimeve të studentit bëhet në mënyrë konfidenciale. Vlerësimet dokumentohen në procesverbalin e detyrimeve dhe në Regjistrin e Rezultateve. Procesverbali i detyrimeve plotësohet nga pedagogu në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e provimit. Në rast të çdo kërkesë për rishikim të vlerësimit ajo meret parasysh nga stukturat përgjegjëse dhe menjëherë nis procedura e shqyrtimit të ankimit në përputhje me rregulloret përkatëse. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit, për rezultatet përfundimtare të vlerësimit brenda afateve si dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë rregullore.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", Neni 25-26</i></p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" KREU IX, Kontrolli dhe vlerësimi i dijes"</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për</p>	<p>Institucioni respekton procedurat e njohjen me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlersimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të</p>

Thurta

<p>rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>studimit. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin brenda 15 ditësh, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Komunikimi i vlerësimeve bëhet në respektim të plotë të privatësisë së studentit. Studenti njihet me rezultatet në portalin e studentit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Duke u bazuar te rregullorja e KU "Wisdom", por edhe te rregullorja e programit dhe dokumenti mbi sistemin e vlerësimit të studentëve ekziston një procedurë, e cila i jep mundësi studentëve të ndjekin këtë proces në mënyrë korrekte. Rivlerësimi i testimit bëhet nga një komision i posaçëm konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", Neni 25-26</i></p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" KREU IX, Kontrolli dhe vlerësimi i dijes,</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.7</p>	
<p>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ duke u bazuar në shqyrtimin e DVV, konfirmon se kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave "E Drejtë Penale" është hartuar në mënyrë të tillë që të grantojë përfitimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, është në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programin e studimit. Kjo kurrikul ka në përbërje lëndë ku merren njohuri të thelluara/specializuara si: E Drejta Penale II (e thelluar), Procedure penale e thelluar,</p>

Murtin

	<p>Kriminologji, Penologji, Kriminalistikë, etj. Të gjitha këto lëndë janë në funksion të formimit të shprehive të veçanta.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneks 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Aneks 2. 10 Studimi i Tregut</i></p> <p><i>Aneks 2.11 Plani Strategjik 2018-2023 Për Programin e Studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, në "E Drejtë Penale".</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>GVJ pasi konsultoi planin mësimor konfirmon se programi i studimit garanton njohuri të përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta. Këto njohuri i japin mundësi studentit të kuptojë tregun e punës, të jetë më komunikues, të punojë në grup, të përdorë teknologjinë e informacionit dhe të fitojë terminologjinë e duhur juridike edhe në anglisht. Institucioni dhe ky program studimi synojnë krijimin e kushteve që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit në aspektin praktik përmes trajnimit të studentit për të përdorur sistemin "Microsoft Teams" dhe sitemin online të shfrytëzimit të literaturës në bibliotekat online.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneks 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Në këtë drejtim kemi nismën e njësisë bazë, e cila realizon në mënyrë periodike analizën e punës, ku kërkon në fund të semestrit nga pedagogu i çdo lënde apo moduli një analizë të punës në lidhje me objektivat e arritura të lëndës si dhe rekomandimet në lidhje me të ardhmen. Departamenti organizon rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Ky rishikim bëhet në bazë të ecurisë së studentëve në lëndë për nivelin e kompetencave dhe aftësive të fituara dhe zbardh konkluzionet në analizën vjetore.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Nën/Dosja (C) Aneks 3 Dosja e plotë Didaktike</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneks 2.16.5 Model /template, Relacion lënde</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më</p>	<p>Referuar RVB, në diskutimin me stafin akademik dhe studentët, në përfundim të çdo lënde/moduli, pedagogu kryen</p>

Thotiu

<p>të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>një përmbledhje të tematikave mësimore të zhvilluara përgjatë procesit mësimor. Pedagogu i çdo lëndë në fund të semestrit para provimit përfundimtar realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.35 Udhëzues Didaktik</i></p> <p><i>Aneksi 3.09 Model /template Plan Kalendarë lënde i plotësuar</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon se në programin e studimit, personeli akademik angazhohet me pedagog të ftuar për të krijuar orë të hapura në trajtën e leksioneve apo seminareve me studentët e këtij cikli studimi. Pas miratimit nga ana Departamentit, njoftimi për ditën dhe orën e mbajtjes së leksionit publikohet në ambientet e Kolegjit Universitar “Wisdom”, si dhe në platformat online.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneksi 3.10.2 Relacion trajnimi “Analiza e sistemit të administrimit të drejtësisë për të mitur”.</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga ajo që u pohua nga stafi akademik në ndihmë të zhvillimit të njohurive të studentëve është gërshëtimi i pjesës teorike me atë praktike në testimin e njohurive të marra në laboratorë, praktikat profesionale, ku në ndihmë të këtij procesi janë marrëveshjet e bashkëpunimit që Institucioni ka në funksion të programit të studimit. Sipas të dhënave në raportin vjetor Institucioni ka 117 marrëveshje bashkëpunimi. Studentët janë të përfshirë përmes Qendrës Klinike Ligjore “Wisdom”, jo vetëm në trajnime por dhe në detyra konkrete të këshillimit ligjor.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.08.14 Praktikë mësimore.</i></p> <p><i>Aneksi 3.10.2 Organizimi i një Vizite mësimore në institucionin e Policisë Shkencore. Kërkesë dhe vendim nr. 157 Prot, datë 11.01.2022.</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e</p>	<p>Duke u bazuar në mënyrën e ndërtimit të silabuseve, por edhe nga takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentët, ky kriter duket se përmbushet plotësisht, pasi mësimdhënia</p>

Thirti 

<p>problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>bazohet në diskutimet e ndryshme, studimet e rasteve, nxitjen e mendimin kritik mbi çështjet që trajtohen duke e vendosur studentin në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimit të dijeve dhe të nxënimit në tërësi.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneksi 3.09 Model /template Plan Kalendar lënde i plotësuar.</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Nga çka u deklarua në takimin me stafin akademik gjatë vizitës në institucion, pedagogët i ftojnë studentët të jenë bashkëpunëtorë në kërkime shkencore dhe botime, duke i mbështetur fort idetë inovative të tyre. Gjithashtu edhe nga ana e studentëve u konfirmua pjesëmarrja e tyre në këto aktivitete.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të Njesisë të kërkimit shkencorë dhe marrëdhënieve me jashtë.</i></p> <p><i>Aneks 4.07 Botimet e Revistës Shkencore Wisdom</i></p> <p><i>Aneks 4.07.1 Botim i studentëve (psh: Botim i Studentes A. Hadarmataj).</i></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Bazuar në përfshirjen në projekte apo përfshirjen në botime të artikujve dhe punëve shkencore në bashkëpunim me pedagogët, apo bashkëpunimi për konferenca kemi disa evidenca lidhur me organizimin e konferencës studentore, e cila është e përvitshme. Në këtë konferencë, studentët duke bashkëpunuar me pedagogët e tyre paraqesin punimet e tyre kërkimore. Mobiliteti i studentëve për këtë program studimi rezulton të jetë 6 studentë pjesëmarrës në Workshop dhe trajnime ndërkombetare. Institucioni akordon një fond vjetor Këshillit të Studentëve si mbështetje për aktivitetet dhe implementimin e ideve inovative.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.29.9 Vendim i Administratores për Fondin e Këshillit Studentor.</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione</i></p> <p><i>Aneks 4.07.1 Botime të studenteve</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese</p>	<p>Për rritjen e aftësive krijuese dhe zbatuese të studentëve dhe për të marrë njohuritë e nevojshme Institucioni ka ndërthurrur shkëmbimet e mobilitetit të studentëve dhe pedagogëve. Kolegji është pjesë e projekteve Erasmus + ka fituar disa</p>

Thuriti

<p>për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>projekte të Erasmus + në cilësinë e “Partner Country” si p.sh. me Universitetin e Split, Kroaci me Universitetin e La Sapienza, Itali, etj, si dhe ka realizuar mobility project, training dhe teaching mobility në kuadër të Projektit Erasmus+ KA107 Programme. Gjithashtu Institucioni ka ndërthurur shkëmbimet e mobilitetit të studentëve dhe pedagogëve me universitete të tjera çka mundëson rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të Njësisë të kërkimit shkencorë dhe marrëdhënieve me jashtë.</i></p> <p><i>Aneks 2.20 Praktikë dokumentacion mobiliteti i stafit akademik (teaching mobility).</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.8</p>	
<p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konfirmon se procesi i diplomimit përmbillet me mbrojtjen e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e tjera të Institucionit janë përcaktuar kriteret dhe mënyra e organizimit. Kriteret për mbrojtje diplome me temë për këtë program studimi bëhen të ditura përmes kordinatorit të programit. Njëzia bazë ka një format të posaçëm për realizimin e reçencës dhe oponencës për çdo student.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, Neni 24.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion</p>	<p>Strukturat përgjegjëse dhe stafi akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të tezës së diplomës. Përsa i përket realizimit të temës së diplomës studentët e këtij programi në</p>

Thuriti

<p>informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>përfundim të këtij cikli studimi, diplomohen si kërkues shkencor në profilin e drejtë penale, pas mbrojtjes së diplomës. Mbrojtja e diplomës me temë ka një procedurë që e lehtëson punën e studentit në drejtim të përzgjedhjes së pedagogut udhëheqës sipas profilit të temës dhe monitorimin e punës përmes seancave të konsultimit që janë të detyrueshme nga studenti për t'u ndjekur përgjatë gjithë procesit. Udhëheqësi udhëzon për strukturën e projektit, metodologjinë, i orienton studentët drejt literaturës që ata duhet të lexojnë në funksion të projektit, u jep udhëzime dhe të gjitha materialet e nevojshme për përfundimin me sukses të projektit kërkimor.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.35 Udhëzues Didaktik</i></p> <p><i>Aneks 3.13 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes të diplomave</i></p> <p><i>Aneks 2.16.11 Model /template, Formular aplikimi për temën</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha njohuritë e fituara në lëndët/ modulet të nevojshme për realizimin e projektit të tyre kërkimorë. Realizimi i një punimi shkencor nga studentët i jep mundësi komisionit të bëjë një vlerësim të kompetencave kërkimore dhe profesionale të përvetësuar nga studentët përgjatë këtij itinerari formavit 2 vjeçar. Bazuar në rregulloren e programit të studimit studentët vihen në dijeni në fillim të semestrit të dytë, të vitit të dytë, nga Përgjegjësi i Departamentit mbi rregulloren e mbrojtjes së punimit të diplomës. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, duke përfshirë dhe testin ndërkombëtar të gjuhës së huaj sipas udhëzimit përkatës, pajiset nga Kolegji Universitar “Wisdom” me Diplomë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom” KREU XI, Përfundimi i studimeve dhe Diplomimi.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, në takimin me personelin akademik u deklarua se procesi i përgatitjes së Projekt kërkimor vlerësohet i rëndësishëm dhe merr vëmendjen e duhur, ai fillon me përzgjedhjen e temës së diplomës për të cilën punohet gjatë semestrit të katërt. Departamenti miraton një listë të temave e cila</p>

Thuriti

	<p>është në përputhje me planin kërkimor të departamentit duke i ofruar studentëve një orientim fillestar rreth mundësisë së realizimit të platformës së projektit kërkimor të tyre për realizimin e punimit të diplomës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.13 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes të diplomave;</i></p> <p><i>Aneks 3.14 Lista e temave;</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik udhëheqës është i angazhuar të ofrojë ndihmën për të lehtësuar procesin e diplomimit të studentëve duke i orientuar. Në ambientet e laboratorit të informatikës funksionon sistemi SPSS, një paketë softuerësh statistikore e zhvilluar për menaxhimin e të dhënave, analitiken e avancuar, analizën etj.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.13 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes të diplomave.</i></p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i diplomës përmes seancave të konsultimit individual i ofron mundësi studentit të ndjekë kriteret në përcaktimin e metodave kërkimore që i lejojnë të mbledh, të administrojë dhe përpunojë të dhënat në mënyrë shkencore. Roli i udhëheqësit fokusohet në mbështetjen dhe ndihmën e studentit që të njoh dhe respektojë kriteret për realizimin e një punimi shkencor origjinal.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e institucionit dhe rregulloren e brendshme të programit të studimit vlerësimi i studentëve në përfundim të provimit të përgjithshëm dhe punimit të diplomës realizohet para komisionit të diplomimit dhe vlerësohet me notë nga ky komision.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", Neni 24.</i></p> <p><i>Aneks 3.13 Rregullore mbi standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes të diplomave</i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me</p>	<p>Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, pajiset nga Kolegji Universitar "Wisdom" me Diplomë "Master</p>

Thurati


<p>diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p><i>i Shkencave</i>". i cili regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Diplomave dhe Certifikatave pranë MASR. Forma e paraqitjes së diplomës është konform profilit dhe njohurive të fituara përgjatë këtij rrugëtimi profesional të studentëve.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" KREU XI, Përfundimi i studimeve dhe Diplomimi. Neni 101-102.</i></p> <p><i>Aneks 3.11 Suplementi i Diplomës</i></p> <p><i>Aneks 3.12 Modeli Diplomës</i></p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ konfirmon se studenti ka të drejtë të kërkojë të marrë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar e cila tërhiqet nga studenti pranë sekretarisë mësimore.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" KREU XI, Përfundimi i studimeve dhe Diplomimi. neni 101-102.</i></p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe paisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Gjithë informacioni mund të tërhiqet prej studentëve të interesuar bazuar në kërkesën e tyre me shkrim.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.07 Rregullore e Sekretarisë Mësimore. Neni 14, pika "u"</i></p> <p><i>Aneks 2.39 Rregullore e Arkivës, neni 11</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

Thurta

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në këtë program studimi. Stafit akademik dhe ndihmës kanë dosjet personale me të dhëna të plota. Kjo zyrë merret me procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe me stafin ndihmës akademik. Kjo zyrë mban evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër. Gjatë vizitës në institucion GVJ pa me përzgjedhje rastësore dosje të personelit akademik ku ishin të grumbulluara informacionet mbi stafin. Dosja e një pedagogu përmbante: CV të përditësuar; Diplomë dhe listë notash; Trajnime dhe kualifikime të ndryshme; vendime të Titujve dhe Gradave; Foto; Listë e publikimeve dhe artikujve të botuar.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.22.1 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit. (për të gjitha vitet që programi i nënshtrohet vlerësimit).</i></p> <p><i>Aneks 2.22.6 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.</i></p> <p><i>Aneks 2 23 Model formati i Dosjes personale të stafit.</i></p> <p><i>Aneks 2.23.1 CV e stafit akademik të programit të studimit.</i></p> <p><i>Aneks 1.09 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore neni 6, pika 7.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se në statutin e Kolegjit, janë përcaktuar kriteret dhe procedura për punësim, respektivisht në nenet 45 dhe 46, si dhe në rregulloren e institucionit në nenin 33. Referuar procedurës së rekrutimit të konsultuar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Kolegji, harton kërkesa të përgjithshme, kriteret bazë si dhe kriteret specifike për stafin e</p>

Theriti 

<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>programit Msc ne “E Drejtë Penale”. Referuar webit të institucionit, rezulton se institucioni publikon në faqen e internetit, thirrjet për punësim të stafit akademik. Në këtë thirrje rezulton e publikuar edhe procedura si dhe metodologjia e vlerësimit nga komisioni ad hoc. Mbështetur në procedurën e konsultuar gjatë vizitës në institucion, si dhe asaj që është pjesë e DVV (dosjes së vetëvlerësimit) për staf akademik, GVJ konstaton se procedura e rekrutimit si dhe vlerësimi mbështeten në kriteret që burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe në metodologjinë e vlerësimit të publikuar në thirrjet për punësim.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Rezulton se kriteret bazë i propozon njësia bazë dhe i miraton dekani, përzgjedhja bëhet nga komisioni ad-hoc i propozuar nga dekani dhe miratuar nga rektori. Kryetar komisioni është dekani. Përzgjedhja bëhet nëpërmjet konkursit. Dekani i propozon rektorit emërimin e kandidatëve fitues, dhe vendimi merret prej rektorit. Personeli akademik me kohë të pjesshme, sipas nevojave të departamenteve, propozohen prej tyre, pas shqyrtimit në mbledhje të Departamentit, dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Kandidatët për këto vende pune konkurojnë me dosje pranë njësisë bazë e cila pasohet me intervistimin dhe përzgjedhjen përfundimtare nga grupi <i>ad hoc</i> i intervistimit. Kandidaturat i nënshtrohen një kontrolli tjetër nga Departamenti të së Drejtës Publike, të cilat i bëjnë Dekanit të FD propozimin për emërimin e tyre kandidatit e renditur i pari në klasifikim. Njoftimi i vendeve vakante bëhet publikisht në web-site, dhe në forma të tjera elektronike.</p>

Dokumentacioni i shqyrtuar

Aneks 1.01 Statuti i KU “Wisdom”, Neni 45, Punësimi i personelit akademik”

Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom” Neni 33, Neni 34.

Aneks 1.09 Rregullore e ZBNjKK&JS Neni 6, pika 2.

Aneks 2.24 Politikat e punësimit dhe procedurat ligjore të rekrutimit të personelit PAE/PAK në FD. Si dhe Shembull: Vendim nr. 412.Prot, datë 21/09/2021 “Për identifikimin e pozicioneve vakante për personel akademik në Departamentin e së Drejtës Publike”.

Aneks 2.24.1 Kriteret e konkurrimit, nr. 407, datë 16/09/2021. “Për personel Akademik në Fakultetin e Drejtësisë KU “Wisdom”.

Aneks 2.23.1 CV e stafit akademik të programit të studimit.

Aneks 2 23 Model formati i Dosjes personale të stafit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Institucioni angazhohet në drejtim të përmirësimit të kushteve të përshtatshme për të realizuar detyrat e gjithsecilit sipas rolit dhe përgjegjësisë. Kapacitetet infrastrukturore në dispozicion, sallat e departamenteve, zyrat, zyrat individuale të drejtuesve, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (poste pune, kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi) janë tregues të një mjedisi të përshtatshëm. Bazuar në informacionet e marra nga takimet me stafin si dhe nga informacioni i siguruar nga RVB rezultojnë se platforma e-learning si dhe mësimi fizikisht në auditor zhvillohet në përputhje me rregulloret e brendshme si dhe ligjet në fuqi. Këto sigurojnë krijimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave. Kolegji ka në dispozicion një godinë gjashtë katesh në Autostradën Tiranë-Durrës me një sipërfaqe 2000 m² nga të cilat 525.30 m² ndertës (3151.8 m² janë sipërfaqe ndërtimi totale) nga të cilat dhe 1.474 m² oborr.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.28 Planimetria dhe kontratë qiraje.</i></p> <p><i>Aneks 2.28.1 Planimetria e mobiluar.</i></p> <p><i>Aneks 2.22.4 Të dhëna Tabelore lidhur me personelin akademik përkatës.</i></p> <p><i>Aneks 2.29 Projekt Buxheti për VA 2021-2022. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe</p>	<p>Referuar RVB por edhe gjatë takimit me Përgjegjësin e Departamentit, me GVB dhe me stafin akademik, rezultoi se kualifikimi i vazhdueshëm i stafit që mbulon këtë program studimi, ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet e këtij</p>

Thurati

<p>administron programin e studimit.</p>	<p>Departamenti. Nuk kanë munguar pjesëmarrjet e pedagogëve mësimdhënës në konferenca të ndryshme shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, botimet në revista shkencore me faktor impakti apo me ISBN. Nuk ka munguar gjithashtu edhe pjesëmarrja dhe përfshirja e pedagogëve në projekte Referuar të dhënave të NJKSHMJ treguesit sasiorë për kërkimin shkencor të stafit akademik në funksion edhe të programit të studimit, në 5 vitet e fundit janë:</p> <p>Numri i botimeve nga PAE i Departamentit është 52 (pesëdhjetë e dy);</p> <p>Numri i projekteve kërkimore të fituara është 27 (njëzet e shtatë);</p> <p>Numri i projekteve të zbatuara është 53 (pesëdhjetë e tre);</p> <p>Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga Departamenti/Fakulteti dhe IAL, për programin e studimit është 18 (tetëmbëdhjetë);</p> <p>Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore është 23 (njëzet e tre).</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore e NJKSH&MJ.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.4 Propozim “Për miratimin e fondi të veprimtarive kërkimore shkencore për VA 2021-2022, të Departamentit të së Drejtës Publike”.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.5 Vendim i Administratores së Sh.p.k “Wisdom”, Për mbështetjen e veprimtarive kërkimore shkencore.</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione</i></p> <p>https://web.uniroma1.it/disp/sites/default/files/Programme%20%2B%20Abstract%20Book%20def.pdf</p> <p>https://wisdom.edu.al/kerkimi-shkencor-dhe-botime</p> <p>https://wisdom.edu.al/cultural-studies-in-business</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni disponon një Plan të Zhvillimit Strategjik të në të cilin janë të specifikuara si pjesë përbërëse e tij kualifikimi i mëtejshëm profesional i personelit akademik. Më tej është zbatimi i tyre i cili mundësohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila organizon trajnimet për rritjen dhe zhvillimin e personelit. Mënyra e zhvillimit të tyre është si me pjesëmarrje fizike ashtu dhe me anë të</p>

Thuriti



<p>personelit akademik e të personelit mësimitor-shkencor.</p>	<p>platformave online. Ekipi ofrues i trajnimeve përbëhet si nga trajnues vendas ashtu dhe trajnues të huaj. KU “Wisdom” në bashkëpunim me Njësinë e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë organizon trajnime për kualifikimin e stafit akademik për të përdorur metodat inovative mësimore.</p> <p>Disa nga instrumentet që përdoren përfshijnë: “Portali i studentit”, http://portal.hstalb.xyz/, i cili këtë vit është zëvendësuar me portalin e ri “Wisdom Kolegji Universitar” www.smartuniform.education/login/ që përfshin të gjitha format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimit, e cila zhvillohet me ndihmën e pajisjeve elektronike, sistemin SPSS, Microsoft Teams (gjatë pandemisë), ProQuest, COBISS.AL.etj.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2. 11 Plani Strategjik 2018-2023.</i></p> <p><i>Aneks 2.37 Udhëzues: Metodatat e mësimdhënies dhe didaktika në kohë pandemie.</i></p> <p><i>Aneksi 3.10.2 Shembull: Organizimi i një Vizite mësimore në institucionin e Policisë Shkencore. Kërkesë dhe vendim nr. 157 Prot, datë 11.01.2022.</i></p> <p><i>Aneksi 3.10.3 Shembull: Relacion trajnimi “Analiza e sistemit të administrimit të drejtësisë për të mitur”.</i></p> <p><i>Aneks 2.30.2 Trajnimi i stafit akademik.</i></p> <p><i>Aneks 2.30.3 Shkresa mbi aktivitetin me të ftuar në kuadër të implementimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Qendrën CILS, Austri 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneks 2 18 Print screen, faqe “PORTALI I STUDENTIT, Materiale Mësimore.</i></p> <p><i>Aneks 218.1 Print screen, faqe “WISDOM KOLEGJI UNIVERSITAR”. www.smartuniform.education/login/</i></p> <p><i>http://portal.hstalb.xyz/</i></p> <p><i>www.cobis.al/</i></p> <p><i>https://ebookcentral.proquest.com/lib.central/wisdom/</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Referuar të dhënave për stafin, ngarkesës së tyre, Cv-ve të tyre, lëndëve që mbulojnë, rezulton se KUW, vë në dispozicion të programit të studimit Msc në “E Drejtë Penale” staf të angazhuar dhe optimizion përdorimin e burimeve njerëzore për realizimin e objektivave të këtij programi.</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022 janë të angazhuar 11 pedagogë ndër të cilët 9 PAE dhe 2 PAK. Personeli Akademik paraqitet</p>

	<p>me kualifikimin, 2 Prof.As.Dr; 3 Dr/PhD., dhe 4 Msc. Ngarkesa e stafit të angazhuar direkt në këtë program studimi shkon nga 45 orë deri në 226 orë në vit.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 90% PAE dhe 10% PAK.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.22.4 Të dhëna Tabelore lidhur me personelin akademik përkatës</i></p> <p><i>Aneks 2.22.5 Të dhëna tabelore mbi cilësinë e stafit mësimdhënës për personelin akademik në programin studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", (për të gjitha vitet që programi i nënshtrohet vlerësimit).</i></p> <p><i>Aneks 2.22.7 Të dhënat tabelore të stafit akademik për programin e studimit, Master i Shkencave në "E Drejtë Penale" sipas moshës për stafin akademik në vitin e fundit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Null përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga ajo çka u vërejt gjatë vizitës në Institucion, GVJ shprehet se Kolegji ka në dispozicion mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit. KU "Wisdom" ka infrastrukturën e nevojshme për mësimdhënie. Auditorët mësimore janë të pajisura me pajisje elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit (mjete audio-vizive, lidhje me internet), të cilat garantojnë një proces mësimor optimal, teorik e praktik dhe me nivele të mira të mësimdhënies.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit,	Nga vizita në institucion si dhe nga dokumentacioni në DVV, konstatohet se ambientet e KUW, klasat, laboratorit, biblioteka, disponojnë pajisje të teknologjisë së informacionit, PC, videoprojektorë, mbulim Wireless, njësi të video-konferencës, etj. Ky kombinim i mjediseve komode si dhe pajisjeve të teknologjisë së informacionit, krijojnë mundësi përdorimi për

Thurte

<p>që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>stafin dhe studentët e programit Msc në “E Drejtë Penale” të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Sistemi i Informacionit të Wisdom dhe Portali i studentit, krijojnë mundësinë që studentët të aksesojnë materialet, leksionet, video tutorialet etj, në formë elektronike.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 27 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</i></p> <p><i>Aneks 2.28 Kontratat qiraje, si dhe Planimetria.</i></p> <p><i>Aneks 2.28.1 Planimetria e mobiluar</i></p> <p><i>Aneks 2.28.2 Certifikatë “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”.</i></p> <p><i>Aneks 1.20 Të dhëna për Platformat online-Struktura e TIK-Biblioteka-Biblioteka online-etj.</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Ky program studimi zhvillohet në ambjentet e KU “Wisdom”, në të cilin vihen në dispozicion salla leksionesh dhe një laborator i teknologjisë së informacionit, pajisje elektronike të tilla si tabela Whiteboard dhe smartboard, wireless. Vlen të theksohet se pozitive është fakti që në ambientet e laboratorit të informatikës funksionon edhe sistemi SPSS, si dhe një sistem për kontrollin e plagjiaturës. Softueri SPSS ofron një sërë veçorish të avancuara, duke e bërë më të lehtë aksesin dhe menaxhimin e të dhënave, zgjedhjen dhe kryerjen e analizave dhe shkëmbimin e rezultateve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Laboratori i teknologjisë së informacionit që është në funksion të zbatimit të këtij program studimi, është i kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe është i aksesueshëm për të gjithë studentët. E gjithë infrastruktura e Institucionit përfshirë edhe rrjeti kompjuterik, janë në monitorim dhe kontroll të vazhdueshëm nga ana e stafit të IT.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 27 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</i></p> <p><i>Aneks 2.28.1 Planimetria e mobiluar.</i></p> <p><i>Aneks 1.17 Udhëzues për Monitorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit.</i></p> <p><i>Aneks1.18 Politika Institucionale e Publikimit të Informacionit.</i></p> <p><i>Ref. https://wisdom.edu.al/zyra-e-it</i></p>

Thuriti

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në Institucion GVJ konstatoi se, Institucioni ka kapacitet të sajën, por edhe në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave mësimore. Institucioni disponon një listë marrëveshjesh me institucione dhe OJF përkatëse për kryerjen e praktikave profesionale pranë tyre.</p> <p>Në funksion të programit, është Qendra “Klinika e Ligjit Wisdom”, me zyrën e saj pranë ambienteve të KU “Wisdom”. Studentët trajnohen edhe pranë zyrave të Profesionistëve të lirë me të cilët FD ka marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera.</p> <p><i>GVJ sugjeron se do të ishte e rëndësishme për programin e studimit një laborator kriminalistike, për të cilën na u pohua se Institucioni ishte duke punuar për hapjen e tij vitin e ardhshëm.</i></p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione.</i></p> <p><i>Aneks 4.08 Marrëveshje të bashkëpunimit në nivel IAL</i></p> <p><i>Aneks 4.09 Marrëveshjeve në nivel Programi Studimi</i></p> <p><i>Aneks 4.10 Marrëveshje bashkëpunimi me aktorë biznesi</i></p> <p><i>Aneks 4.14 Statuti, Qendra “Klinika Ligjore Wisdom”.</i></p> <p><i>Aneks 4.15 Relacion nga Qendra Klinika Ligjore “Wisdom”.</i></p> <p><i>Aneksi 3.10. IShembull i një Kërkese/Kthim Përgjigje të Praktikës mësimore</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve</p>	

<p>bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka hapësira dhe u jep mundësi studentëve të bëjnë kërkime online apo të studiojnë materiale fizike në një mjedis me hapësira dhe kushte komode për studim. Ajo është e pajisur me tavolina studimin, kompjuter dhe internet pa limit përmes sistemit wi-fi për të gjithë studentët dhe anëtarët e personelit që duan të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës për shfletim të literaturës për nevoja të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB në fondin e bibliotekës janë rreth 1642 tituj fizik dhe 3863 copë libra fizik gjithsej, si dhe 65162 revista/buletine shkencore në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, fond ky në format hardcopy dhe elektronik, i cili aktualisht plotëson nevojat e të gjithë përdoruesve. Salla e literaturës është e organizuara me fonde të hapura të ndara sipas degëve të shkencës. Biblioteka ka krijuar edhe katalogun on-line. Biblioteka ka 47 poste pune në shërbim të stafit akademik dhe studentëve të KU “Wisdom”, Përdoruesve të bibliotekës u mundësohet aksesit në internet, por edhe përdorimi i 12 laptopëve, për përgatitjen e detyrave të kursit, apo punimeve të tezave. Kolegji Universitar “Wisdom” ka vënë në dispozicion bibliotekën online që lehtëson realizimin me sukses të programit të studimit, të projekteve kërkimore shkencore dhe përgatitjen e tezës së diplomës. Studentët kanë akses në shfrytëzimin online të faqes elektronike ProQuest sipas interesave të tyre të studimit. Çdo student/pedagog ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekën mësimore dhe të përdorimit të katalogut elektronik online cobis.al.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Shërbimet e bibliotekës ofrohen pa pagesë për të gjithë studentët e KU “Wisdom” dhe për personelin e institucionit. Për t’u bërë anëtar i bibliotekës mjafton një regjistrim i thjeshtë me një kartë indentiteti dhe një fotografi dhe studenti hap librezën e bibliotekës. Përmes saj studentët dhe stafi kanë të drejtë të tërheqin libra nga biblioteka për afate të përcaktuara.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Çdo vit akademik, FD në përgjithësi dhe departamentit të së Drejtës Publike në veçanti, hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të Bibliotekës në mbështetje të programit të studimit. Biblioteka e KU “Wisdom” është bibliotekë akademike dhe si e tillë ofron në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, literaturë shume disiplinore dhe mundësi të eksplorimit</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje</p>	

edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj

dhe të studimit të literaturës në fushën e kërkimit shkencor sipas kërkesave specifike.

Biblioteka vendos në shërbim të përdoruesve materiale bibliotekare në përshtatje me kërkesat akademike, shkencore dhe kulturore të tyre, siguron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës akademik dhe administrativ (libra, CD-ROM, fjalorë, internet, salla e leximit). Kjo sallë u vjen në ndihmë studentëve jo vetëm për studim, por edhe për fotokopje të materialeve të ndryshme bibliotekare. Biblioteka është pasuruar edhe me revista shkencore në fushën e drejtësisë. Pasurimi i literaturës në përputhje me kurrikulën mësimore është proces i vazhdueshëm, që kryhet nëpërmjet blerjeve të planifikuara, dhurimeve, artikujve shkencore, tezave të diplomave, si dhe nëpërmjet pasurimit periodik të Buletinit Shkencor "Wisdom") të aksesueshme edhe në faqen web të KU "Wisdom"<http://www.wisdom.edu.al/>
<https://wisdom.edu.al/kerkimi-shkencor-dhe-botime>.

Portali i studentit <http://portal.hstalb.xvz/teacher/library/>, me seksionin Libraria, vjen në ndihmë të studentëve të programit. Biblioteka e KU "Wisdom" është pjesë e sistemit kombëtar bibliografik COBISS.AL. Çdo student e pedagog ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të përdorimit të katalogut elektronik online <https://al.cobiss.net/>.

<https://ebookcentral.proquest.com/lib.central/wisdom/>.

Sipas të dhënave referuar në RVB, biblioteka elektronike Proquest ofron 187.641 tituj total libra online akademik, në format PDF, si: Law, Philosophy, Business, Literature, English dhe janë të aksesueshme, për studentët e personelin akademik. Ku rreth 184.353 janë Revista Shkencore online dhe 36.482 periodik në platformën e ProQuest. Materialet bibliotekare janë regjistruar dhe përpunuar sipas kërkesave ligjore, IFLA (World Information and Information Congress) dhe Ligjit nr. 8576, datë 03.02.2006. "Për bibliotekat ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Rreth 163.342 tituj total libra online akademikë janë të aksesueshëm vetëm në fushën e drejtësisë në linkun përkatës. Biblioteka është e hapur nga e hëna në të premte prej orës 08:30-19:30. <https://wisdom.edu.al/biblioteka>.

GVJ sygjeron që Institucioni duhet të shtojë numrin e posteve të punës në këtë sallë, pasi numri 47 nuk është i mjaftueshëm për

Murti

	<p><i>numrin e studenteve që ajo ofron. Nga ajo çka u referua, Kolegji ka afro 400 student në të gjitha programet e tij të studimit, ndaj shtimi i 100 vëndeve do të ishte optimale.</i></p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" Neni 112, Biblioteka.</i></p> <p><i>Aneks 1.20 Të dhëna për Platformat online-Struktura e TIK-Biblioteka-Biblioteka online etj</i></p> <p><i>Aneks 2 21 Relacion për Bibliotekën e KU "Wisdom", Bashkëngjitur lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë të shtuar vitet e fundit.</i></p> <p><i>Aneks 2 21.1 Abonim revista juridike</i></p> <p><i>Aneks 2 21.2 Marrëveshje Cobiss.al</i></p> <p><i>Aneks 2 21.3 Marrëveshje Proquest</i></p> <p><i>Aneks 2 21.4 Wisdom press procedurat e krijimit</i></p> <p><i>Aneks 2.16.10 Model /template, Kartele regjistrimi në bibliotekë</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sekretaria mësimore e KU "Wisdom" administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelore në formatin hard copy dhe elektronikisht. Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se menaxhimi dhe administrimi i gjithë informacionit që lidhet me studentët ndër vite kryhet nga Sekretaria mësimore (kryesekretaria e fakultetit). Të dhënat mbi ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim; statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, largimet etj të cilat disponohen dhe elektronikisht janë të regjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Indeksit, Rezultateve Akademike dhe Diplomave. Në mbështetje të gjithë veprimtarisë së

Thurton

	<p>Kolegjit është edhe sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit “Portali i studentit”. Wisdom Kolegji Universitar-</p> <p>www.smartuniform.education/login.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.07 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të KU “Wisdom” Neni 2</i></p> <p><i>Aneks 1.17 Udhëzues për Monitorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit.</i></p> <p><i>Aneks 1.18 Politika Institucionale e Publikimit të Informacionit</i></p> <p><i>Ref: Regjistrat hard-copy të programit të studimit (të aksesueshme gjatë vizitës)</i></p> <p><i>Aneks 2 18 Print screen, faqe “Portali i Studentit, Materiale Mësimore</i></p> <p><i>Aneks 2 18.1 Print screen, faqe Wisdom Kolegji Universitar- www.smartuniform.education/login/</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Referuar RVB si dhe takimeve ne institucion, rezulton se sistemi i brendshëm i menaxhimit, administron informacionin për aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, e personelit administrativ si dhe të dhënavë të studentëve. Hallka të këtij sistemi menaxhimi, realizohen nga aktivitetet e Zyrës së burimeve njerëzore Karrierës dhe Jetës studentore, prej Koordinatorës së përgjithshme të Kolegjit, prej Sekretarisë mësimore si dhe nga NJKSHMJ. Për arkivimin dhe mbajtjen e dokumentacionit zyrtar dhe akademik të Kolegjit Universitar Wisdom, rezulton se respektohen dispozitat e parashikuara në Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, dhe në rregulloren e institucionit për arkivat dhe protokollin.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU “Wisdom”, Neni 116, “Arkiva dhe Protokolli”.</i></p> <p><i>Aneks 1.09 Rregullore e ZBNjKK&JS. Neni 6, Kompetencat dhe detyrat.</i></p> <p><i>Aneks 1.18 Politika Institucionale e Publikimit të Informacionit</i></p> <p><i>Aneks 2.22.6 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse</i></p>

	<p><i>Aneks 2.22.1 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit (për të gjitha vitet që programi i nënshtrohet vlerësimit)</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NJKSH&MJ</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit pranë KUW, ofron akses në informacion personave të autorizuar sipas të drejtave që ata kanë në. GVJ kosntatoi ruajtje të bazës së të dhënave për burimet njerezore, të gjithë procedurave, qe prej incimit të kërkesave për staf nga departamentet dhe në vazhdim të gjithë procedurës së rekrutimit. Po ashtu informacioni i plotë garantohej për të dhënat e studentëve. Për studentët, informacioni rezulton të ofrohet kryesisht prej Portalit të Studentit. Për të gjitha këto funksionalitete të sistemit te menaxhimit, GVJ siguroi informacion jo vetëm nga DVV, por edhe nga takimet me studentët, sekretarine si dhe zyrën e burimeve njerëzore pranë KUW.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom", Neni 103.</i></p> <p><i>Aneks 1.17 Udhëzues për Monitorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit.</i></p> <p><i>Aneks 1. 18 Politika Institucionale e Publikimit të Informacionit .</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar vizitës në institucion, nga takimet me studentët dhe me stafin e programit, rezulton se studentët e programit aksesojnë informacionin rreth programit të studimit, syllabuseve, vlerësimeve semestrale lëndore, komunikimin e pedagogun si dhe leksionet e detyrat e tyre nëpërmjet Portalit të Studentit, qe është një platformë elektronike komunikimi dhe qe lejon komunikimin interaktiv, pedagog- student. Ndërkohë studentët kanë mundësinë edhe të shfrytëzimit të fondit të bibliotekës, nëpërmjet platformave elektronike.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1. 20 Të dhëna për Platformat online</i></p> <p><i>Aneks 1.09 Rregullore e ZBNjKK&JS, Neni 115.</i></p> <p><i>Aneks 2 18.1 www.smartuniform.education/login</i></p> <p><i>Ref. https://wisdom.edu.al/udhezuesi-i-karrieresshih</i></p> <p><i>Aneks 2.25 Plani i punës i ZBNjKK&JS</i></p> <p><i>Aneks 2.25.1 Procesverbal "Për zgjedhjen e studentëve/senator sipas grupeve"</i></p>

	<i>Aneks 2.26.1 Informacion mbi Studentët e Diplomuar në KU "Wisdom" në VA 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019,19-20, 20-21.</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<p>Në statutin dhe rregulloren e KUW, rezultojnë të sanksionuara përgjegjësitë që strukturat respektive kanë në monitorim aktivitetet akademike dhe administrative. Komunikimi rezulton të bëhet nëpërmjet emailit të brendshëm. Nga vizita në institucion, nga takimet me drejtuesit dhe takimi me NJSBC si dhe informacioni i siguruar, GVJ konstaton se strukturat monitoruese hartojnë raporte për ecurinë e proceseve dhe për funksionimin e strukturave, duke i shërbyer vendimmarrësve, për të pasur informacion të plotë për institucionin, si dhe për të adresuar zgjidhje për problematikat që mund të identifikohen.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.02 Rregullore e KU "Wisdom" Neni 118 "Zyra e shërbimeve".</i></p> <p><i>Aneksi 2 13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike</i></p> <p><i>Aneks 2. 07 Raporti vjetor i KU "Wisdom", VA 2020-2021</i></p> <p><i>Aneks 4 02 Relacion i Analizës Vjetore të Njesisë të kërkimit shkencorë dhe marrëdhënieve me jashtë. www.wisdom.edu.al</i></p>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe .	<p>Nga vëzhgimi i webit të KUW, konstatohet se institucioni ka publikuar, të dhëna për programet e studimeve, për procedurat e rekrutimit, strukturat ne mbështetje të studentëve, informacione për bursat, informacione për mundësitë e praktikave si dhe për aktet rregullative të institucionit etj. Këto informacione janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Webi ne të dy gjuhët, rezulton funksional</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 18.1 www.smartuniform.education/login/</i></p> <p><i>https://wisdom.edu.al/en</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Jo përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

M. Kurti

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Referuar dokumenteve të shqyrtuara nga DVV, Institucioni ka qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, ku rezulton se çdo vit paraqet një raport financiar në të cilin paraqiten në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.29 Projekt Buxheti për VA 2021-2022. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.1 Tarifa e studimit për programin e studimit VA 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.2 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.3 Të dhënat nga zyra e financës, pasqyrat financiare 17-2021.</i></p> <p><i>Ref: https://wisdom.edu.al/cilat-jane-tarifat-e-studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit të programit të studimit përfshin në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe aksesin në bibliotekat on-line. Ky plan financimi i programit të studimit Msc. në “E Drejtë Penale” është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet në drejtimin që ato do përdoren.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.29 Projekt Buxheti për VA 2021-2022. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.3 Të dhënat nga zyra e financës, pasqyrat financiare.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e</p>	<p>Institucioni kryen auditim të përvitshëm bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion. Ka një pasqyrë të hollësishme</p>

<p>financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.29 Projekt Buxheti për VA 2021-2022. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.3 Të dhënat nga zyra e financës, pasqyrat financiare 17-2021</i></p> <p><i>Aneks 2.29.2 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Nga dokumentat e shqyrtuar në dosje provohen raportet financiare për tri vitet e fundit akademike. Tabela përmbledhëse e të dhënave nga plani i financimit të programit të studimit paraqet të ardhurat dhe shpenzimet kryesore për 3 vitet e fundit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.29.3 Të dhënat nga zyra e financës, pasqyrat financiare.</i></p> <p><i>Aneks 2.29 Projekt Buxheti për VA 2021-2022. Të dhëna nga Raporti financiar</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Sipas të dhënave në RVB, Institucioni ka dëshmuar një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, ka shlyer në kohë çdo lloj detyrimi financiar ndaj të tretëve.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.29.2 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.3 Të dhënat nga zyra e financës, pasqyrat financiare.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ duke u bazuar në DVV dhe në informacionin e publikuar në web site si dhe në vizitën në institucion konstaton se KUW në aktet e tij rregullatore, konkretisht në rregulloren e KUW dhe në rregulloren e transferimeve ka të parashikuar politika, procedura dhe kritere për pranimin, përparimin, dhe transferimin, si dhe njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve. Kriteret për pranim në program, propozohen nga njësia bazë dhe ato rezultojnë të miratuara nga senati. Kriteret për vlersimin e studentëve janë të sanksionuar në rregulloren e KUW, ato paraqiten edhe në programet e cdo lënde. Në KU “Wisdom” funksionon edhe ZBNjKK&JS, e cila ka në varësi Specialistin e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore i cili informon dhe orienton studentët për pranimet në programet e studimit dhe ndjek ecurinë e studenteve deri në diplomim. Krahas këtyre politikave me qëllim rritjen e procesit të orientimit dhe qëndrimin sa më pranë tregut të punës është ngritur edhe Bordi i Biznesit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statuti i KU “Wisdom”, Neni 10 pika f, 66 Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve.</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, Kreu V, Neni 30-36.</i></p> <p><i>Aneks 2.15 Vendim Senatit, “Mbi miratimin e kuotave të pranimit të studentëve me kohë të plotë të programeve të studimit.</i></p> <p><i>Aneks 1.09 Rregullore e ZBNjKK&JS, Neni 6, pikat 13 deri 25.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KUW ka një sërë rregulloresh dhe procedurash duke filluar nga niveli institucional në tërësi, tek njësia kryesore dhe tek njësia bazë, apo edhe e programit të studimit që mbulojnë një cikël të plotë 2 vjeçar nga hyrja deri në diplomim të studentëve. Këto akte nënligjore sanksionojnë të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit të studimit. Formulari i Vlerësimit të studentit, demonstron reflektimin e kritereve të vlerësimit të parashikuara në rregullore. Ndjekja akademike bëhet dhe nga Sekretaria</p>

M. Kurti

	<p>mësimore. Studentët në mënyrë të barabartë kanë akses në informacionet lidhur me programin e studimit. Në shërbim të studentit janë dhe Guida e studentit, Udhëzuesit Didaktik, Udhëzuesi i praktikave dhe Udhëzuesi i karrierës të gjitha lehtësisht të aksesueshme përmes faqes web.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.41 Guida e Studentit https://wisdom.edu.al/guida-e-studentit</i></p> <p><i>Ref. http://portal.hstalb.xyz/</i></p> <p><i>Ref. https://wisdom.edu.al/udhezuesi-i-karrieres</i></p> <p><i>Ref. https://wisdom.edu.al/njoftime</i></p> <p><i>Aneks 1.07 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të KU "Wisdom", Neni 3.</i></p> <p><i>Aneks 1.18 Politika Institucionale e Publikimit të Informacionit.</i></p> <p><i>Aneks 1.17 Udhëzues për Monitorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit.</i></p> <p><i>Aneks 2.36 Udhëzuesin e Praktikave https://wisdom.edu.al/ofrohen-praktika-ne-institucionet-shteterore-apo-private</i></p> <p><i>Aneks 2.35 Udhëzues Didaktik</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumenteve të vëna në dispozicion, përsa i përket kriterëve dhe procedurave të pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit të ciklit të dytë, aksesohen lehtësisht nga të interesuarit. Në faqen zyrtare të institucionit janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studenti. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë trasperente. Procedurat që lidhen me transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku përmes informacionit në faqen e KU "Wisdom" mbi këtë procedurë dhe dokumentat e kërkuar për transferimin e studimeve konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2. 09 Rregullore e transferimeve</i></p> <p><i>Aneks 2.14 Të dhëna Tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit.</i></p>

Martini

<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>KU "Wisdom" në përputhje me ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Senatit Nr. 5, datë 27.01.2021, ka miratuar kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, dhe i pasqyron këto informacione edhe në faqen zyrtare duke i mundësuar aksesin kujtdo që është i interesuar në çdo kohë. Pranimi i studentëve në programin Msc. në "E Drejtë Penale" është rregulluar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave, me anë të të cilit vendoset nota mesatare në hyrje për çdo vit akademik.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale", Neni 31, 36.</i></p> <p><i>Aneks 2.15 Vendim Senatit, "Mbi miratimin e kuotave të pranimit të studentëve me kohë të plotë të programeve të studimit.</i></p> <p><i>Ref: https://wisdom.edu.al/guida-e-studentit</i></p> <p><i>Aneks 1.07 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të KU "Wisdom", Neni 3.</i></p> <p><i>Aneks 1.18 Politika Institucionale e Publikimit të Informacionit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjeve rezulton se Institucioni përpara fillimit të çdo viti akademik, informon studentët për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. Gjithashtu, informon mbi mundësitë e zhvillimit të karrierës, stafin dhe gjithçka tjetër që iu duhet për të bërë një zgjedhje të preferuar bazuar mbi njohuritë, dëshirën, interesin personal dhe mundësitë e punësimit dhe progresit. Informimi i studentëve të ardhshëm bëhet përmes faqes zyrtare të web-it, fletëpalosje, njoftimeve në rrjetet sociale, njoftimeve e informacioneve në ambientet e KU "Wisdom" si dhe nëpërmjet publikimit të Guidës së KU "Wisdom" si dhe Udhëzuesit Didaktik.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.26.3 Angazhimi i pedagogëve për ditët e informimit të maturantëve.</i></p> <p><i>Aneks 1.19 Politika e Marketingut, fq 7-8.</i></p> <p><i>Ref: https://wisdom.edu.al/guida-e-studentit</i></p> <p><i>Aneks 2.35 Udhëzues Didaktik</i></p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore, por edhe takimet informuese që realizohen ditët e para të fillimit të vitit akademik, lehtësojnë njohjen e studentit me këto procedura.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit.</i></p> <p><i>Aneks 2. 08 Rregullore Departamentit të së Drejtës Publike</i></p> <p><i>Aneks 2. 09 Rregullore e transferimeve</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet “Java e Orientimit”, e cila është e përvitshme në kolegji. Gjatë kësaj jave realizohen takime, leksione të hapura për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të KU Wisdom-it. Në çdo lëndë apo modul janë përcaktuar qartë të gjitha informacionet që lidhen me procedurat që ndjek institucioni për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka procedura të unifikuara për të gjithë njësitë e tij, të cilat janë të bazuara në udhëzimet e MASR për strukturën e hartimit të sylabusit të lëndës. GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se institucioni, mban regjistrimet e plota të përparimit akademik të studentëve, proceverbalet e notave etj. Gjithashtu institucioni informon për detyrimet e studentëve për të kaluar nga një vit në tjetrin.. Studentët rezultuan të informuar për kriteret dhe procedurat e vlerësimit si dhe detyrimet lëndore, nga pedagogët në seancën e parë të cdo lënde si dhe në Portalin e Studentit. Sekretaria informon ata në fillim si dhe për cdo kërkesë specifike</p>

Therli



	<p>rreth kriterëve, kushteve, dokumentacionit për transferimet, të parashikuara këto në rregulloren e transferimeve.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Annex 3.08 - Annex 3.08.10 Curricula (syllabi)</i></p> <p><i>Annex 3.08- Annex 3.08.17 Curricula (syllabi)</i></p> <p><i>Aneks 2. 09 Rregullore e transferimeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se në manualin për punimin e temës së diplomës, studenti njihet me udhëzime të specifikuar lidhur me strukturën e punimit të diplomës, i cili është gjithashtu pjesë e prezantimit që bëhet në fillim të vitit akademik. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Monitorimin e këtyre procedurave që lidhen me mbrojtjen e diplomës me temë, e realizon koordinatori i Departamentit në bashkëpunim me njëzinë bazë dhe stafin akademik.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.38 Udhëzuesi i Diplomave</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Institucioni ndjek politika që synojnë reklamimin dhe promovimin e tij në vazhdimësi. Në lidhje me tërheqjen e studentëve të rinj çdo fillim viti akademik KU “Wisdom” organizon grupe pune të përbëra nga pedagogë të cilët informojnë studentët me programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t’i ndihmuar ata në vendimarrje. Format si; njoftimet në faqen zyrtare të web, rrjetet sociale, stendat e Kolegjit dhe guidës së studentit ndërmerren me qëllim tërheqjen e studentëve të interesuar. Gjithashtu kolegji merr pjesë në panairët e karrierës. Zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore organizon çdo fillim viti ditët e orientimit gjatë të cilave studentët njihen mbi programin e studimit si dhe strukturat e Kolegjit Universitar “Wisdom”.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.41 Guida e Studentit</i></p> <p><i>Aneks 2.35 Udhëzues Didaktik</i></p> <p><i>Aneks 2.26.3 Angazhimi i pedagogëve për ditët e informimit</i></p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, Neni 36.</i></p>

Martini

	<p><i>Aneks 2.26.2 Njoftim për organizimin e ditëve të Panairit Work & Study.</i></p> <p><i>Aneks 1.18 Politika Institucionale e Publikimit të Informacionit</i></p> <p><i>Aneks 1.19 Politika e Marketingut, fq. 8.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve përmes një morie formash. Duke nisur me informacionin në faqen online të KU “Wisdom”-it, përmes kontratës që nënshkruan, informacionit që merr nga zyra e Kujdesit për studentët, këshillimit nga stafi akademik në faza të ndryshme si dhe rregullores mësimore të programit të studimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, Neni 36.</i></p> <p><i>Nën/Dosja (C), Dosja e plotë Didaktike</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Në dispozicion të studentëve të programit të studimit aksesimi tek informacioni mbi kurrikulën dhe programin e studimit mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së rregjistrimit, gjatë ditëve të orientimit, Departamenti i së Drejtës Publike në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, organizon takime informuese me studentët, si dhe u prezanton studentëve Udhëzuesin Didaktik. Edhe nëpërmjet platformave dixhitale studentët mund të marrin informacion për lëndët që do të zhvillojnë përgjatë semestrit dhe vitit akademik.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.35 Udhëzues Didaktik</i></p>

Taviti

	<p><i>Aneks 2.26.3 Angazhimi i pedagogëve për ditët e informimit</i></p> <p><i>Aneks 1.09 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, këshillimit të karrierës dhe jetës studentore, Neni 6, pikat 13 deri 25.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë takimit në Institucion GVJ u informua se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore informon studentët mbi nevojat që ka tregu i punës, hapësirat e punësimit. Institucioni ka marrëveshje me një sërë institucione dhe ente private e shtetërore për të nxitur punësimin e studentëve. Gjithashtu në ndihmë të punësimit të studentëve vjen edhe Bordi Këshillimor i Biznesit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.25 Plani i punës i ZBNjKK&JS.</i></p> <p><i>Aneks 2.26 Vendim nr. 214 dt 17/04/2019, “Për krijimin e Bordit këshillimor të Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjate takimit me studentet rezultoi se ata merrnin informacion te detajuar mbi zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën nga sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit, si dhe nga Zyra e Sekretarisë nga pedagogët përkatës apo nëpërmjet faqes së tyre të internetit në portal. Informacionin e marrin gjithashtu nëpërmjet specialistit të zyrës së Karrierës si dhe nëpërmjet Guidës së studentit.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimi të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Çdo informacion aksesohet nga cilido i interesuar në kohë reale</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p>http://www.wisdom.edu.al/</p> <p>http://portal.hstalb.xyz/</p> <p>www.smartuniform.education/login</p> <p>https://wisdom.edu.al/specialist-i-karrieres-dhe-jetes-studentore</p> <p>https://wisdom.edu.al/zyra-e-it</p>

Martini

	<p>https://wisdom.edu.al/biblioteka</p> <p>https://wisdom.edu.al/sekretaria</p> <p>https://wisdom.edu.al/oraret</p> <p>https://wisdom.edu.al/kalendari-akademik</p> <p>https://wisdom.edu.al/guidat-e-studentit.</p> <p><i>Aneks 2 27 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks 1.20 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online.</i></p>			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Sikurse e cituam dhe më lart, sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit administron gjithë informacionin e nevojshëm mbi aktivitetin mësimorë të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	<p>KUW harton dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit. . Këto të dhëna mbahen manualisht nga sekretaria si dhe në mënyrë elektronike në data bazën e sektorarisë së KUW. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi per katër vitet akademike është:</p> <p>Në vitin akademik 2018-2019 20 studentë;</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020 25 studentë;</p> <p>Në vitin akademik 2020-2021 33 studentë;</p> <p>Në vitin akademik 2021-2022 14 studentë.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p>

	<i>Aneks 2. 14 Të dhëna Tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve.</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në Msc.” E Drejtë Penale”. Numri i studentëve të larguar rezulton 2 studentë ndër vitet akademike, konkretisht 1 në vitin akademik 2018 – 2019 dhe 1 në vitin akademik 2019 – 2020.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Statistikat për ecurinë e studentëve janë të pasqyruara përgjatë 2 viteve akademike në të cilat ky program ka zhvilluar veprimtarinë. Të dhënat fokusohen në numrin e studentëve sipas viteve të studimit, nota mesatare e hyrjes dhe e daljes, student të transferuar sipas viteve Dokumentacioni i shqyrtuar <i>Aneks 2. 14 Të dhëna Tabelore mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve.</i> <i>Regjistrat themeltarë hard-copy të aksesueshme gjatë vizitës në IAL).</i>
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ referuar të dhënave dhe regjistrave që institucioni mban, konstaton se KUW mban të dhëna të vazhdueshme për përparimin akademik të studentëve, procesverbalet lëndore, vleresimet si dhe statusin e studentëve në cdo lëndë, regjistrime këto që përveç procesverbaleve analitike të cdo lënde në hard copy dhe në soft copy, hidhen edhe në regjistrat themeltar. Këto forma të kombinuara të mbajtjes së të dhënave, GVJ i vlerëson pozitivisht, sepse rrisin sigurinë e ruajtjes së të dhënave, por edhe shpejtësinë e sigurimit të informacionit nga përdoruesit e autorizuar të tyre.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Referuar RVB Institucioni harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Dokumentacioni i shqyrtuar <i>Aneks 1.09 Rregullore e ZBNJKK&JS, neni 6 pikat 13 deri 17;</i>

	<p><i>Aneks 2.26.1 Informacion mbi Studentët e Diplomuar në KU "Wisdom" në VA 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019,19-20, 20-21;</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021;</i></p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si këshillin e studentëve, i cili është grupim i studentëve dhe për zgjedh përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të KU "Wisdom". Përfshirja e studentëve në një sër strukturash vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përcaktuar në aktet ligjore dhe rregulloren dhe statutin e vetë IAL-it. Në Senatin Akademik përfshirja e tyre përbëjnë 15% (nga 13 anëtarë gjithsej 2 janë student).</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.25.1 Procesverbal "Për zgjedhjen e studentëve/senator sipas grupeve".</i></p> <p><i>Aneks1.01 Statuti i KU "Wisdom", Neni 14 Senati Akademik dhe organizimi i tij, Neni 73 Këshilli i Studentëve.</i></p> <p><i>Aneks 2. 03 Vendim Rektori, nr. 101 Prot, datë 09/12/2021, "Për miratimin e Grupit të Vetëvlerësimit të Brendshëm, për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale".</i></p> <p><i>Aneks 2.19 Vendim "Për emërim e anëtarëve NJSBC".</i></p> <p><i>Aneks 2.19.1 Të dhëna për anëtarët e NJSBC.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e</p>	<p>Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e</p>

Therter

<p>studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>studentëve. Ato janë pjesë aktive e mbedhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.32 Vendimet e emërimit të organeve drejtuese në KU "Wisdom" në të cilat studentët gëzojnë statusin e anëtarit me të drejta të plota.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave jo burokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ngarkesa akademike e studentëve në këtë program studimi është hartuar dhe zbatohet duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore të institucionit dhe në harmoni me udhëzimet dhe vendimet e MASR. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesa e shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra (afërsisht 30 ECTS për semestër). Referuar RVB, sasia e punës së kryer gjatë një viti akademik në programin e studimit nga një student është 60 ECTS ose 1 500 orë mësimore punë të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur nga ana e tij. Studentët nuk paraqitën ndonjë ankesë për procedura të tej zgjatura.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneksi 2.08 Rregullore Departamentit të së Drejtës Publike Neni 8;</i></p> <p><i>Aneks 3.03 Plani Mësimorë;</i></p> <p><i>Aneks 3.04 Kuadri i përgjithshëm i veprimtarive formuese të programit;</i></p> <p><i>Aneks 2.22.8 Të dhëna Tabelore për ngarkesën totale në auditor të studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale".</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit duke kryer anketime të rregullta dhe reflektuar mbi sugjerimet e tyre. Nëpërmjet këtyre anketimeve/ pyetësorëve të studentëve, studentët shprehen edhe mbi procesin mësimorë dhe programet e studimit apo mbi ndershmërinë dhe barazinë në procesin e vlerësimit të dijeve. Një tjetër aspekt që lidhet me përfshirjen e tyre është edhe takimi i njësisë bazë me student e pedagogë mbi cilësinë në mësimdhënie.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.16.3 Model /template, Pyetësori i studentit.</i></p>


Thurati

<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Bazuar në dokumentet e paraqitura por dhe në takimin gjatë vizitës në takim me studentët, nuk na u paraqit ndonjë ankim nga ana e studentëve. Ata u shprehen se arrijnë ti adresojnë shqetësimet e tyre, në Këshillin Studentor, direkt me pedagogët, drejtuesin e departamentit nëse është e nevojshme.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.16.9 Model /template, Formular i vlerësimit të vazhdueshëm të studentit;</i></p> <p><i>Aneks 2.16.3 Model /template, Pyetësori i studentit;</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.6</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga dokumentet e paraqitura në DVV dhe nga takimi me stafin akademik rezulton një pjesëmarrje e kënaqshme e stafit akademik në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare, përfshirje në zbatim të projekteve etj</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.16.6 Model /template, Formular vlerësimi i performancës së personelit akademik.</i></p> <p><i>Aneks 2.23.1 CV e stafit akademik të programit të studimit.</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në DVV, Kolegji ka 117 marrëveshje bashkëpunimi, me institucione kërkimore shkencore e të arsimit të lartë kombëtare e ndërkombëtare, në nivel institucional, kompani private, studio ligjore, institucione shtetërore, organizata jofitimprurëse dhe shoqata të ndryshme, 20 marrëveshje partneriteti janë me universitete të huaja me të cilat ka patur aktivitete të përbashkëta. Këto marrëveshje</p>


Therter

	<p>garantojnë përfshirjen e stafit në aktivitete të mirëfillta kërkimore shkencore jashtë vendit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NjKSH&MJ</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët rezultoi se stafi i nxit studentët e programit, të përfshihen në aktivitete kërkimore shkencore. Studentët janë përfshirë edhe në programin Erasmus+. Personeli akademik publikon në Revistën shkencore “Wisdom” me numrin serial: ISSN 2410-8472.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione</i></p> <p><i>Aneks 4.07 Botimet e Revistës Shkencore Wisdom</i></p> <p><i>Aneks 4.07.1 Botim teksti i Studentes së FD A. Hadarmataj.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Siç edhe u referua nga personeli akademik gjatë takimit, Kolegji mbështet publikimin në revista shkencore të stafit akademik, duke i mbështetur financiarisht, përfshirë edhe studentët, duke marrë përsipër publikimin e kërkimeve shkencore në revistat shkencore ndërkombëtare. Të njejta deklarime u dhanë edhe nga studentët.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.29.4 Propozim, “Për miratimin e fondi të veprimtarive kërkimore shkencore për VA 2021-2022, të Departamentit të së Drejtës Publike”.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.5 Vendim i Administratores së Sh.p.k “Wisdom”, Për mbështetjen e veprimtarive kërkimore shkencore.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>GVJ konstatoi se personeli akademik nxit pjesëmarrjen e studentëve në kërkimin shkencor dhe disa nga temat e trajtuara në këtë program studimi janë inovative.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.07 Botimet e Revistës Shkencore Wisdom</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe</p>	<p>Personeli akademik ka një rol aktiv përgjatë gjithë këtij procesi duke mbështetur studentët në gjenerimin e ideve dhe përzgjedhjen e fushës së tyre kërkimore, ofron asistencën e nevojshme për përcaktimin e metodologjisë së punës dhe</p>


Thurthi 

përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës.	<p>kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës. Ky rol diktohet edhe nga Udhëzuesi i diplomimit dhe monitorohet nga strukturat e njësisë bazë. Në ndihme të punimit të diplomës është dhe salla e laboratorit të informatikës ku funksionon sistemi SPSS, kjo është një paketë softuerësh statistikore e zhvilluar për menaxhimin e të dhënave, analitiken e avancuar, analizën, si dhe sistemi për kontrollin e plagjiaturës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 27 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i></p> <p><i>Aneks 2.38 Udhëzuesi i Diplomave.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Referuar të dhënave në dokumentat e DVV stafi i Kolegjit aderohet në projekte të ndryshme kërkimore brenda dhe jashtë vendit si programet “Horizont 2020” dhe Erasmus+ duke e vendosur Kolegjin Universitar “Wisdom” si partner në kuadër të mobilitetit të stafit dhe të studentëve. Institucioni ka 117 marrëveshje bashkëpunimi me qëllim zgjerimin dhe forcimin e bashkëpunimit shkencor dhe arsimor, shkëmbimin e personelit akademik (pedagog, kërkues) për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore; shkëmbimin e studentëve; nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore–shkencore; organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, etj.</p> <p>Vlen të përmendet fakti që në Kolegj funksionojnë 3 qendra OJF ku dy janë në funksion të mbështetjes të Fakultetit të Drejtësisë, Intituti për kërkim dhe zhvillim si dhe Klinka Ligjore “Wisdom” të cilat në veprimtarinë e tyre kanë aderimin</p>



	<p>në projekte vendase dhe ndërkombëtare në funksion të kërkimit shkencor dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.08 Marrëveshjet në nivel Institucional/ Fakulteti të Drejtësisë</i></p> <p><i>Aneks 4.09 Marrëveshjet në nivel Programi Studimi</i></p> <p><i>Aneks 4.10 Marrëveshje bashkëpunimi me aktorë biznesi.</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NjKSH&MJ</i></p> <p><i>Aneks 2.20 Praktikë dokumentacion mobiliteti i stafit akademik (teaching mobility).</i></p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Modulet e lëndëve të caktuara të cilat realizohen nga studentët përgjatë ndjekjes së këtij program studimi, kanë një impakt të dukshëm në zhvillimin e kompetencave për të kryer kërkime shkencore dhe për të ndihmuar në implementimin e projekteve të ndyshme. Një pjesë e mirë e temave të diplomës në të cilat ato janë të përfshijnë i ndihmon studentët të fitojnë shprehitë e duhura për vazhdimin e kërkimit shkencor. Kapacitetet dhe njohuritë e marra mundësojnë vijimin më tej të studimeve në ciklin e tretë (niveli 8 i KSHK-së).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore shkencore vendase dhe të huaj në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të realizuara, si dhe mbështetjen financiare të tyre. Gjatë takimit studentët pohuan që stafi akademik i përfshinë në projekte kërkimore, ku në disa artikuj të botuar studentët janë bashkautorë.</p> <p><i>GVJ rekomandon përfshirjen e institucionit në më tepër projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, për t'iu dhënë më tepër mundësi integrimi studentëve në projekte kërkimore e shkencore.</i></p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.29.5 Vendim i Administratores së Sh.p.k "Wisdom", Për mbështetjen e veprimtarive kërkimore shkencore.</i></p> <p><i>Aneks 2.29.6 Kriteret për alokimin e fondit vjetor të kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione</i></p> <p><i>Aneks 4.07.1 Botime të studenteve.</i></p>



<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Fryrma e bashkëpunimit me institucionet e huaja shihet në aktivitetet e ndërmarra në kuadër të lehtësimit të mobilitetit të personelit akademik për të krijuar eksperiencë profesionale jashtë, por gjithashtu kemi edhe akses për stafin akademik të huaj në KU “Wisdom” përmes organizimit të orëve të hapura, organizimit të konferencave të përbashkëta shkencore.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.30 Shkresë mbi aktivitetin me të ftuar Psh: Phd David Kolb; Prof. Maria Casola.</i></p> <p><i>Aneks 2.30.1 Shkresë mbi aktivitetin me të ftuar në kuadër të implementimit të marrëveshjes me CILS.</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion mbi ecurinë dhe zbatueshmërinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit 2017-2022, NJKSH& MJ me FD, fq 10.</i></p> <p><i>Aneks 1.14 Strategji e Kërkimit Shkencor, projekteve, Partneriteteve e mobilitetit ndërkombëtar.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Sikundërse u tha gjatë takimit me stafin dhe studentët, Institucioni në sajë të marrëveshje të bashkëpunimit me institucione universitare ndërkombëtare si dhe përfshirjes në programin Erasmus+ dhe të tjerë, u krijon mundësi që studentët të përfshihen në mobilitet, ku në mesin e tyre ishte prezent edhe një student që ishte përfshirë në eksperiencë jashtë. Në fakt u konstatua një indiference e studentëve për të mos marrë pjesë në këto trajnime.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 4.03 Relacion tabelat e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione.</i></p> <p><i>Aneks 4.02 Relacion i Analizës Vjetore të NJKSH&MJ</i></p> <p><i>Aneks 4.04 Relacion mbi ecurinë e veprimtarive kërkimore shkencore 2017-2022</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Nga dokumentat e paraqitur në DVV rezulton se Institucioni fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj. Në funksion të ndërkombëtarizimit ka realizuar marrëveshje bashkëpunimit me institucione universitare ndërkombëtare dhe në zbatim të tyre personeli akademik kanë ardhur për periudha kohe të caktuara në kuadër të shkëmbimit akademik.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p>

Thuriti

	<p><i>Aneks 2.30 Shkresë mbi aktivitetin me të ftuar Psh: Phd David Kolb; Prof. Maria Casola,</i></p> <p><i>Aneks 2.30.1 Shkresë mbi aktivitetin me të ftuar në kuadër të implementimit të marrëveshjes me CILS.</i></p> <p><i>Aneks 4.05 Relacion mbi ecurinë dhe zbatueshmërinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit 2017-2022.</i></p> <p><i>Aneks 4.04 Relacion mbi ecurinë e veprimtarive kërkimore shkencore 2017-2022</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.8	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni ka zyrën e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore e cila është në shërbim të informimit të studentëve. Ajo që vihet re është që ka një njohje jo të plotë dhe të detajuar të funksionit të kësaj zyre. Kjo zyrë përdor faqen zyrtare e webit www.wisdom.edu.al ku pasqyron aktivitetet që zhvillohen në Kolegjin Universitar “Wisdom” dhe përditëson informacione të detajuara për studentët, stafin dhe palët e treta. Institucioni është aktiv dhe në rrjetet sociale.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.18 Politika Institucionale e Publikimit të Informacionit;</i></p> <p><i>Aneks 1.21 Të dhëna nga faqja zyrtare e Web-it;</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me	Institucioni ka funksional një sistem për menaxhimin e informacionit online bazuar mbi platformën “Portali i Studentit” i cili siguron informacionin e nevojshëm për studentët. Ky sistem menaxhon gjithë informacionin dhe materialet didaktike në ndihmë të procesit mësimorë. Po ashtu ky intucion me qëllim mbështetjen profesionalisht të studentëve dhe ti ndihmojë ata në planifikimin e karrierës ofron dhe udhëheqje

Thurati

<p>procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>dhe kujdestari (tutorat) për studentët, dhe përgjegjëse për këtë është zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore e cila ofron mbështetje në drejtim të koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve për tu orientuar në tregun e punës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.17 Udhëzues për Monitorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit;</i></p> <p><i>Aneks 2.26.4 Relacion i specialistit të zyrës së karrierës</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore /specifikisht njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Në KU “Wisdom” funksionon Alumni, me të cilët bëhen takime të përvitshme për të marrë mendime, ndarë eksperiencë në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t’iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës. ”Ditët e Karrierës” janë gjithashtu veprimtari të përvitshme të cilat synojnë të ndihmojnë studentët në fazat e ndryshme të vendimarrjes për zgjedhjen e karrierës profesionale në linjë me mundësitë, nevojat dhe aftësitë personale të tyre. Këto aktivitete orientojnë studentët në përzgjedhjen e profilit, dhe më pas në lehtësimin e përzgjedhjes së institucioneve të zhvillimit të praktikës profesionale në linjë me programin e studimit. Seminare të hapura, lektorë të ftuar janë pjesë e promovimit të profesioneve të ndryshme për studentët e saj. Këshilluesi i karrierës është në dispozicion të studentëve gjatë gjithë javës dhe ofron një sër shërbimesh si këshillim karriere, informacion mbi vende të lira pune, informacion mbi praktikën</p>

M. Kurti

	<p>profesionale, informacion në lidhje me trajnimet dhe workshop-et etj.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.09 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, Neni 6 pikat 13 deri 25.</i></p> <p><i>Aneks 2.25 Plani i punës i ZBNJJK&JS</i></p> <p><i>Aneks 2.26.1 Informacion mbi Studentët e Diplomuar në KU "Wisdom" në VA 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019,19-20, 20-21.</i></p> <p>https://wisdom.edu.al/specialist-i-karrieres-dhe-jetes-studentore</p>
--	---

<p>Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore është një strukturë e ngritur e cila funksionon në bazë të statutit të Kolegjit Universitar "Wisdom" e cila ka si objektivi të punës së saj mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë viteve të punësimit. Shpesh luan një rol të rëndësishëm në orientimin e studentit drejt mundësive të punësimit, por edhe në drejtim të ofrimit të këshillimit për karrierën me qëllim vlersimin më objektivi të mundësive që student ka në dispozicion. Kjo zyrë me qëllim që të lehtësojë intinerarin e kalimit nga shkolla në punë përpunon të shfrytëzojë asetet e saj si bordi i punës dhe panairt e punës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.09 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, Neni 6 pikat 13 deri 25.</i></p> <p><i>Aneks 2.25 Plani i punës i ZBNJJK&JS.</i></p> <p><i>Aneks 2.26.1 Informacion mbi Studentët e Diplomuar në KU "Wisdom" në VA 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019,2019-2020, 2020-2021.</i></p>
--	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Thurton

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE /ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në raport me politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit kemi disa element të dallueshëm. Institucioni ka miratur një grup pune, i cili do të drejtojë këtë strukturë, ku janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme. Struktura në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për funksionimin e saj siç është Rregullorja për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Strukturat e ngritura nga Institucioni janë: Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe NjSBC. Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë harton politikat për garantimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.6 Politika për garantimin e cilësisë në KU "Wisdom".</i></p> <p><i>Aneks 2.19 Vendim nr. 12 Prot, dt 10/06/2020 "Për emërim e anëtarëve NJSBC</i></p> <p><i>Aneks 1.06 Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i></p> <p><i>Aneks 1.11 Rregullore e Komisionit për Garantimin e Standardeve të Cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>NjSBC është përgjegjëse për respektimin e standardeve të cilësisë në gjithë programet e studimit të Kolegjit. Ajo bashkëpunon me fakultetet dhe departamentet për vlerësimin periodik të programeve mësimore, cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor. Procesi i punës së NjSBC-së, përfshin mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve dhe të diplomuarve, intervistimin e pedagogëve dhe të studentëve, këto të dhëna raportohen në një një raport</p>


Theriu

	<p>përmbledhës i cili analizon situatën e institucionit apo të programit të studimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statuti i KU "Wisdom", neni 27.</i></p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneks 1.06 Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i></p> <p><i>Aneks 2.19 Vendim "Për emërim e anëtarëve NJSBC".</i></p> <p><i>Aneks 2.19 .1 Të dhëna për anëtarët e NJSBC.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni ka aplikuar për akreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë. Ka ndjekur të gjitha procedurat burokratike që lidhen me këtë proces. ASCAL ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit për këtë program studimi. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se kolegji i kushton një rëndësi të veçantë rekrutimit të stafit akademik me tituj e grada shkencore. Për sigurimin e cilësisë institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët, stafin akademik, takimet në grup për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2. 02 Të dhëna për aktet themelore, licencime, akreditime, të Programi i studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Penale".</i></p> <p><i>Aneks 1.01 Statuti i KU "Wisdom", Neni 11, Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Ashtu siç u referua më sipër, Institucioni ka hartuar dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes planit të saj të veprimit synon që për këto qëllime të realizojë trajnime me stafin akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët. Pjesë e këtyre trajnimeve do të jenë zyra e burimeve njerëzore, njësisë për kërkimin shkencor, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, kordinatorët e departamenteve dhe senati akademik. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet</p>

Murtu

	<p>gjatë vizitës në institucion, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional ka politika që synojnë përmirësimin e cilësisë për programin e studimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.6 Politika për garantimin e cilësisë në KU "Wisdom"</i></p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneks 1.01 Statuti i KU "Wisdom", neni 27.</i></p> <p><i>Aneks 1.06 Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	<p>Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe Kurrikulës, harton politikat në lidhje me monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë. NjsBC është njësi e posaçme përgjegjëse për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit. Ajo bashkëpunon ngushtë me NJKSH&MJ dhe njësinë bazë për garantimin e cilësisë. Departamenti është përgjegjës për përgatitjen e propozimeve për ndryshimin e kurrikulave.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.6 Politika për garantimin e cilësisë në KU "Wisdom"</i></p> <p><i>Aneks 1.12 Rregullore e Komisionit për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Kurrikulën.</i></p> <p><i>Aneks 2.16 Relacion ndryshimi, Plani Mësimorë 2017-2018, dhe plani i ri 2018-2019, si dhe Vendim nr. 48 prot, dt. 12/10/2018. "Për miratimin e planeve mësimorë të Fakultetit të drejtësisë për vitin akademik 2018-2019".</i></p>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e	Nga dokumentat e paraqitura rezulton se NjsBC merr informacion periodik lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe

Thuriti 

<p>të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>çështje që lidhen me procesin mësimor akademik, si dhe efikasitetin e programeve të ofruara. Procedura fillon me propozimin e departamentit, shqyrtimin nga komisioni i posaçëm, kalimin nëpërmjet dekanit dhe rektorit në Senatin Akademik për miratim.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.12 Rregullore e Komisionit për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Kurrikulën.</i></p> <p><i>Aneks 2 19.4 Relacion i pyetësorëve të studenteve të FD.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni përdor metodologji vlerësimi si dhe instrumente matëse vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të tilla si: metoda të tërthorta Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit); Takime në grup (në fund të vitit), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës. Komisioni njofton në mënyrë zyrtare strukturat përgjegjëse dhe përgjatë procesit të monitorimit përdor format raporte që të japin mundësi të vlerësosh aspekte të ndryshme që lidhen me mënyrën sesi respektohen standartet nga strukturat përgjegjëse</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneks 2 19.5 Kalendar i kontrollit e brendshëm</i></p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021.</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB, raportet periodike të vlerësimit i paraqiten Dekanit, Rektorit dhe diskutohen në Senatin e KU “Wisdom”, i cili miraton planin e masave për adresimin e problemeve të evidentuara. Analizat dhe raportet vjetore për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneks 2. 07 Raporti vjetor i KU “Wisdom”, VA 2020-2021</i></p>

Therit

<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se formati i raporteve të vlerësimit përfshin të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneks 2.13 Analiza vjetore e Departamentit të së Drejtës Publike VA 2020-2021.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përkrahje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>GVJ konstaton se raporti i vetëvlerësimit të programit të studimit kryhet në mënyrë periodike dhe ky proces përfshin të gjithë aktorët duke filluar që nga Njësia Bazë me grupet e sigurimit të cilësisë. Përsa i përket strukturës që merret me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, ai është i lidhur me KSBC. Kjo strukturë monitoron standartet e cilësisë për të gjitha programet e studimit në rang universiteti. Grupi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë është ngritur nga departamenti me qëllim hartimin e një raport vlerësimi të brendshëm për këtë program studimi.</p>

Theritij

<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Nga informacioni i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, u konstatua se institucioni për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda e instrumente të ndryshme të tilla si: pyetësi i studentëve, takimet në grup që zhvillohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Instrumentat janë të hartuara në mënyrë të tillë që masin dhe vlerësojnë të gjithë komponentët e programit të studimit. Gjithashtu në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësimit të pedagogëve si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC 2020-2021.</i></p> <p><i>Aneks 2.16.3 Model /template, Pyetësi i studentit</i></p> <p><i>Aneks 2.16.4 Model /template, Pyetësi për mbledhjen e opinionëve të pedagogë.</i></p> <p><i>Aneks 2.16.5 Model /template, Relacion lënde</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinsticionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstaton se një ndër metodat e drejtpërdrejta të përdorura nga institucioni janë vlerësimet e drejtpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe rishikimit të kurikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik apo studentëve. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësim të didaktikës përmes vlerësimit të stafit akademik nga një koleg me tituj, si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.16.6 Model /template, Formular vlerësimi i performancës së personelit akademik</i></p> <p><i>Aneks 2.16.7 Model /template, Formular i vlerësimit të studentit praktikant.</i></p> <p><i>Aneks 2.16.8 Model /template, Formular të kërkimit shkencor</i></p>

	<p><i>Aneks 2.16.9 Model /template, Formular i vazhdueshëm i vlerësimit.</i></p> <p><i>Aneks 2 19.5 Kalendari i kontrollit e brendshëm</i></p> <p><i>Aneks 2.40 Udhëzuesi për masat ndaj covid-19, si dhe plani i masave</i></p> <p><i>Aneks 2 19.4 Relacion i pyetësorëve të studenteve të FD.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program me qëllim përmirësimin e cilësisë. GVJ konstaton se institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi ku përfshihen pyetësorët dhe fokus grupet e realizuara me studentët të cilat zhvillohen në baza periodike dy herë në vit pyetësorë dhe një herë në vit fokus grupe. Vlersohet puna e bërë nga institucioni në këtë drejtim.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.4 Relacion i pyetësorëve të studenteve të FD.</i></p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC vitin akademik 2020-2021.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4


Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të</p>	<p>IAL ka krijuar strukturat për sigurimin e cilësisë ku përfshihen KSBC, Departamentet dhe Fakulteti në të gjitha hallkat e sigurimit të cilësisë, duke siguruar përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. NJSBC përbëhet nga 5 anëtarë, nga ku një përfaqësues nga çdo njësi kryesore dhe i paangazhuar në detyra të nivelit të lartë, si dhe një student. Gjithashtu</p>

Thuriti

<p>interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>institucioni garanton dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të parametrave të cilësisë. Për këtë ekzistojnë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.03 Vendim Rektori, nr. 101 Prot, datë 09/12/2021, "Përmirësimin e Grupit të Vetëvlerësimit të Brendshëm, për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "E Drejtë Penale"</i></p> <p><i>Aneks 2.19.1 Të dhëna për anëtarët e NJBSC.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton së detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të palëve të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në rregulloren e NJSBC. KSBS përmes aktiviteteve që ndërmer synon të garantojë sigurimin e cilësisë. Për arritjen e këtij qëllimi janë angazhuar në realizimin e projekteve koordinatori i projektit, grupi i punës nga institucioni me anëtarë të cilët janë të profileve dhe mbulojnë punën në struktura të ndryshme si zyra e kurrikulës, komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë, njësia për kërkimin shkencor dhe angazhimin e anëtarëve të departamenteve sipas rastit dhe aktiviteteve.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021.fq 16-22.</i></p> <p><i>Aneks 1.01 Statuti KUW (Alb)</i></p> <p><i>Aneks 1.06 Rregullore e Njësisës Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në përbërjen e grupit të vlerësimit të brendshëm janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik dhe studentë. Departamenti është përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë përmes mbështetjes me informacione dhe akses në të gjitha dokumentat që disponon, grupi i vlerësimit të brendshëm. Personeli ndihmësakademik e administrativ ka mbështetur punën e grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që lehtësojnë procesin.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.16.3- 2.16.4 Pyetësori i studentit dhe pedagogëve</i></p>

Thuriti



	<i>Aneks 2.19.4 Relacion i pyetësorëve të studenteve të FD</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit nuk ushtron detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë. Gjithashtu edhe përfshirja e studentëve nga bachelor dhe masterat në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Gjatë takimit në Institucion GVJ u informua se përfshirja e bashkëpunëtorëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të cilësisë kryhet nëpërmjet konferencave e takimeve të organizuara në nivel fakulteti apo Kolegji. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe “ <i>Bordit këshillimor të Biznesit</i> ”, i cili ndihmon dhe jep një ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij. Dokumentacioni i shqyrtuar <i>Aneks 2.26 Vendim nr. 214 dt. 17/04/2019, “Për krijimin e Bordit këshillimor të Biznesit ”</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente. Politikat e institucionit në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit janë në funksion të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e KU “Wisdom”. Funksionet e NjSBC janë parë nga ana e Institucionit si një pjesë integrale e menaxhimit

	<p>të procesit akademik-mësimor, por gjithashtu edhe si një instrument për rritjen e performancës.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 1.01 Statuti i KU "Wisdom".</i></p> <p><i>Aneks 2 19.6 Politika për garantimin e cilësisë në KU "Wisdom".</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Programi në fjalë është në akreditim periodik. Akreditimi i parë është bërë në vitin 2016. IAL bën publike për stafin dhe studentët rezultatet e pyetësoreve duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale. Aktorët e interesuar njihen me këto raporte përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit të dokumentave.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Referuar RVB rezultatet e vlerësimit të bëra nga NJSBC, analizat e departamentit dhe fakultetit shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Raportet e vlerësimit shoqërohen me rekomandime dhe propozime masash për adresimin e çështjeve të ngritura dhe përmirësimin e cilësisë të cilat diskutohen dhe miratohen nga senati i kolegjit. Plan i punës dhe raportet japin rekomandime të cilat i paraqiten Rektorit i cili më pas ndërmer hapa për të trajtuar dhe zgjidhur problematikat.</p> <p>Dokumentacioni i shqyrtuar</p> <p><i>Aneks 2.19.2 Plani i NJSBC veprimtarive kryesore për vitin akademik 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021</i></p> <p><i>Aneks 2 19.6 Politika për garantimin e cilësisë në KU "Wisdom".</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, krijon grupin përmes delegimit të përgjegjësisë, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vet institucioni për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Ashtu sic ndërmerren reagime nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm.</p>

Tartu

	Dokumentacioni i shqyrtuar <i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021.</i> <i>Aneks 2. 07 Raporti vjetor i KUW.</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	GVJ konstaton se institucioni me anë të veprimtarive periodike si java e orientimit, sesione trajnimi të shumta që realizon në fillim të çdo viti akademik, informon dhe ndërgjegjëson studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Angazhimin e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë e kërkon baza ligjore në funksion të cilësisë në mësimdhënie si edhe nga rregulloret e KU “Wisdom” dhe statuti, një sër strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre (KSBC, GVB). Dokumentacioni i shqyrtuar <i>Aneks2.19.2 Plani i NjSBC veprimtarive kryesore për vitin akademik 2021-2022.</i> <i>Aneks 2 19.3 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJSBC për vitin akademik 2020-2021</i> <i>Aneks 2 19.6 Politika për garantimin e cilësisë në KU “Wisdom”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Duk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Duk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Murti

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave/
Arteve në “E Drejtë Penale”**

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë Penale” është në përputhje me standardet kombëtare si dhe misionin dhe objektivat strategjike të Kolegjit Universitar “Wisdom”;
2. Departamenti në bashkëpunim me NJSBC është i angazhuar në vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së stafit akademik dhe atij administrativ;
3. Përfshirja e studentit në vlerësimet periodike të formave të mësimdhënies dhe të stafit akademik;
4. Stafi akademik efektiv mbulon programin dhe gëzon titujt dhe gradat akademike në përmbushje të detyrimeve ligjore;
5. Infrastruktura, krijon kushtet e duhura për studentet, stafin akademik dhe administrativ, në shërbim të këtij program studimi;
6. Ndërveprim aktiv pedagog-student;

b. Pika të dobta

1. Mungesa e zhvillimit të moduleve / lëndëve në gjuhë të huaj, gjë e cila do të ndikonte në rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombtarizimit të Kolegjit;
2. Mungesa e një Laboratori të Kriminalistikës, i cili do të shërbente në funksion të cilësisë së programit të studimit të studimit;
3. Përfshirje e ulët e studentëve të programit në projekte dhe në kërkimin shkencor të njësisë bazë;

Rekomandime

1. Zhvillimi i një moduli / lënde në gjuhë të huaj, do të ndihmonte në thithjen e studentëve të huaj dhe rritjen e mobilitetit në kuadër të ndërkombtarizimit të institucionit;
2. GVJ rekomandon krijimin e një laboratorit të kriminalistikës i cili do të ishte i rëndësishëm dhe në funksion të rritjes së cilësisë për programin e studimit;
3. GVJ rekomandon rritjen e numrit të studentëve në projekte kërkimore e shkencore kombëtare e ndërkombëtare për t’ju siguruar vijueshmëri dhe përgatitje për ciklin e tretë të studimeve;

Thirti

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Scientific Master in Criminal Law

a. Strengths and affirmations:

1. The Master of Science study program in "Criminal Law" is in line with national standards and the mission and strategic objectives of the "Wisdom" University College;
2. The Department in cooperation with NJSBC is engaged in continuous evaluation of the performance of the academic and administrative staff;
3. Involvement of the student in the periodic evaluations of the forms of teaching and of the academic staff;
4. Effective academic staff covers the program and holds academic titles and degrees in fulfilment of legal obligations;
5. Infrastructure creates the right conditions for students, academic and administrative staff, in the service of this study program;
6. Active pedagogue-student interaction;

b. Weaknesses

1. Lack of development of modules / courses in foreign languages, which would affect the increase of mobility within the research and internationalization of the College;
2. Lack of a Forensic Laboratory, which would increase the quality of the study program;
3. Low involvement of the students of the program in projects and research of the basic unit;

Recommendations

1. Development of a module / subject in a foreign language, would help in the incoming of foreign students and increase mobility in the framework of the internationalization of the institution;
2. EEG recommends the establishment of a forensic laboratory which would be important and increase the quality of the study program;
3. EEG recommends increasing the number of students in national and international research and scientific projects to ensure attendance and preparation for the third cycle of studies;

Thirti

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X